



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN**  
**E TIRANËS**

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**



### **MBI AUDITIMIN E “SISTEMEVE TË** **TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT” NË** **UNIVERSITETIN E TIRANËS**

**Tiranë, Dhjetor 2022**

## PËRMBAJTJA

| Nr.         | EMËRTIMI                                                                                                     | Faqe         |
|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| <b>I.</b>   | <b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>                                                                                | <b>4</b>     |
|             | <b>1</b> Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit                                                       | <b>4</b>     |
|             | <b>2</b> Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve                                                     | <b>5</b>     |
|             | <b>3</b> Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit                                                 | <b>7</b>     |
| <b>II.</b>  | <b>HYRJA</b>                                                                                                 | <b>7</b>     |
|             | <b>1</b> Objekti i auditimit                                                                                 | <b>8</b>     |
|             | <b>2</b> Qëllimi i auditimit                                                                                 | <b>8</b>     |
|             | <b>3</b> Identifikimi i çështjes                                                                             | <b>8</b>     |
|             | <b>4</b> Përgjegjësitë e strukturave drejtuese                                                               | <b>9</b>     |
|             | <b>5</b> Përgjegjësitë e audituesve                                                                          | <b>9</b>     |
|             | <b>6</b> Kriteret e vlerësimit                                                                               | <b>9</b>     |
|             | <b>7</b> Standardet e auditimit                                                                              | <b>10</b>    |
|             | <b>8</b> Metodatat e auditimit                                                                               | <b>10</b>    |
|             | <b>9</b> Dokumentimi i auditimit                                                                             | <b>10</b>    |
| <b>III.</b> | <b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>                                                                                | <b>10</b>    |
|             | <b>1</b> Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim                                                | <b>10</b>    |
|             | <b>2</b> Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit                                              | <b>11</b>    |
|             | <b>2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK</b>                                                         | <b>11-17</b> |
|             | <i>Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK</i> |              |
|             | <i>Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit</i>                                |              |
|             | <b>2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit</b>                                 | <b>17-50</b> |
|             | <i>a Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime.</i>                |              |
|             | <i>b Procedurat e Investimeve në fushën TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të shërbimit.</i>                     |              |
|             | <b>2.3 Auditimi i Sigurisë së Informacionit</b>                                                              | <b>51-59</b> |
|             | <i>a Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet</i>                                       |              |
|             | <i>b Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit</i>                                         |              |
|             | <b>2.4 Auditimi i Sistemeve</b>                                                                              | <b>59-61</b> |
|             | <i>a Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/output.</i>                               |              |
|             | <i>b Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre</i>    |              |
| <b>IV.</b>  | <b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>                                                                              | <b>61</b>    |

## LISTA E SHKURTIMEVE

| <b>Shkurtimi</b> | <b>Emërtimi i Plotë</b> |
|------------------|-------------------------|
|------------------|-------------------------|

|                |                                                                           |
|----------------|---------------------------------------------------------------------------|
| <b>KLSH</b>    | Kontrolli i Lartë i Shtetit                                               |
| <b>RSH</b>     | Republika e Shqipërisë                                                    |
| <b>APP</b>     | Agjencia e Prokurimit Publik                                              |
| <b>SPE</b>     | Sistemi i Prokurimit Publik                                               |
| <b>RASH</b>    | Rrjeti Akademik Shqiptar                                                  |
| <b>AKSHI</b>   | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit                           |
| <b>AKCESK</b>  | Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike |
| <b>BCP</b>     | Business Continuity Plan                                                  |
| <b>ALCIRT</b>  | Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike                               |
| <b>BCC</b>     | Business Continuity Center                                                |
| <b>MNSH</b>    | Marrëveshjeve Nivel Shërbimi                                              |
| <b>AK</b>      | Autoriteti Kontraktues                                                    |
| <b>OE</b>      | Operator Ekonomik                                                         |
| <b>TI(IT)</b>  | Teknologjia e Informacionit                                               |
| <b>TIK</b>     | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi                                |
| <b>VKM</b>     | Vendim i Këshillit të Ministrave                                          |
| <b>KM</b>      | Këshilli i Ministrave                                                     |
| <b>PBB</b>     | Produkti i Brendshëm Bruto                                                |
| <b>COBIT</b>   | Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse      |
| <b>INTOSAI</b> | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit            |
| <b>ISSAI</b>   | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit           |
| <b>BE</b>      | Bashkimi Evropian                                                         |
| <b>SSL</b>     | Secure Sockets Layer                                                      |
| <b>VPN</b>     | Virtual Private Network                                                   |
| <b>LAN</b>     | Local area network                                                        |
| <b>IP</b>      | Internet Protocol                                                         |

## **1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Universitetin e Tiranës, nga data 30.05.2022 deri më datë 30.09.2022.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### **I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin e Tiranës është pjesë e Planit Vjetor 2022 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Universiteti i Tiranës disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Nga ana e subjektit janë përcjellë në KLSH dy kopje të Projektraportit të auditimit të shoqëruar me deklaratën e nënshkruar nga titullari i insitucionit Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e dërguara mbi akt konstatimet dhe projektraportin e auditimit. Në konsideratë janë marrë ato kundërshti për të cilat janë paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Mbështetur në punën audituese në terren, evidencat e marra kanë qenë të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar. Auditimi i sistemeve të Informacionit është e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria

## I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

| Gjetje nr. | Përmbledhje e Gjetjes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Referenca me Raportin Përfundimtar | Rëndësia | Rekomandimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1.         | Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Tiranës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit ose përfshirje të saj në strategjinë institucionale, duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave.                                                                                                                                                             | faqe 11-17                         | E Lartë  | Strukturat drejtuese të Universitetit të Tiranës, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit. Gjithashtu, UT të marrë masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të përcaktuara |
| 2          | Nga auditimi i procedurave të prokurimit TIK rezulton se në të paktën 4 procedura janë kërkuar kritere të veçanta kualifikimi jo në përputhje me objektin e prokurimit, konkretisht :<br>1)Procedura Blerje pajisje Elektronike, softje për përpunimin e të dhënave cilësore programe software, aplikacion për studentët, , sistem kamerash” viti 2020<br>2)“Blerje pajisje elektronike dhe audiovizuale për UT viti 2021<br>3)“Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2020.<br>4)Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2021 | faqe 17-50                         | E Lartë  | Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që nga ana e grupeve të punës që do të ngrihen për hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të mos hartohen kritere që janë jashtë objektit të prokurimit të cilat përbëjnë shkas për mos-nxitje të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë                                                                                                      |
| 3          | Nga auditimi u konstatua se Administratori i FSHN ka dërguar preventivin dhe specifikimet teknike me shkresën nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 ku vlera e preventivit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | faqe 17-50                         | E Lartë  | Universiteti i Tiranës të nxjerrë përgjegjësitë dhe të kërkohej ndjekja e procedurave të nevojshme administrative dhe ligjore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |

|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |            |         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|---|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|   | <p>është 9,700,000 lekë, dukshëm një vlerë më e ulët se planifikimi fillestar në buxhet i këtij projekti, i cili ishte në vlerën 14,500,000 lekë. FSHN ka argumentuar se janë konstatuar pasaktësi në vlerësimin paraprak që ishte bërë për efekt të buxhetit por janë rishikuar edhe zgjidhje teknike të verifikuara në terren të cilat kanë dhënë efekte në uljen e preventivit dhe në përmirësimin e infrastrukturës së fakultetit. Në vlerën e miratuar ishte përfshirë edhe ndërtimi i një website të ri dinamik me vlerë 2,000,000 lekë por duke qenë se ishin në përfundim të afatit të aksesit të faqes ekzistuese në google, nga FSHN për këtë website është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh në fakultet. Për sa më sipër, vlera e planifikuar është konsideruar si e ezauruar duke e zbritur shumë nga planifikimi fillestar.</p> |            |         | <p>për të mundësuar arkëtimin e vlerës 2,000,000 lekë pa TVSH mbi ndërtimin e një website për FSHN ndërkohë që vetë fakulteti ka sqaruar se për këtë website është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh dhe vlera është konsideruar si e ezauruar duke e zbritur vlerën nga planifikimi fillestar i buxhetit.</p>                                                                         |
| 4 | <p>Nga auditimi u konstatua se UT nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | faqe 51-59 | E Lartë | <p>Strukturat drejtuese në Universitetin e Tiranës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.</p> |

|   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |            |         |                                                                                                                                                                                                                      |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 5 | Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Tiranës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve | faqe 51-59 | E Lartë | Strukturat Drejtuese në Universitetin e Tiranës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre. |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

### I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2020-31.12.2021 në të cilat përfshihet Qeverisja IT, Siguria e Informacionit, procedurat e prokurimeve TIK

- Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH” datë 27.11.2014.

- Sipas opinionit tonë, Investimet e kryera në Universitetin e Tiranës në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm. Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për, procedurat e prokurimit publik për investimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2020 deri më 31.12.2021, subjekti i audituar, Universiteti i Tiranës”, ka mangësi në veprime në përputhje me kriteret e përcaktuara në bazën ligjore dhe rregullatore

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 468/3, datë 27.05.2022 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 27.05.2022 deri në 30.09.2022, në Universitetin e Tiranës, ku periudha e audituar është 01.01.2020 deri në 31.12.2021, u krye auditimi me objekt “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, nga audituesit:

1. R.A, Përgjegjës Grupi
2. B.H, Anëtar
3. E.C, Anëtare
4. M.P, Anëtare
5. A.K, Anëtare
6. K.S Anëtare

### II.1. Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

### II.2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në Universitetin e Tiranës është dhënia e opinionit apo vlerësimit nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Për të arritur në dhënien e një opinionit, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efikase. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### II.3 Identifikimi i çështjeve:

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr.468/3, datë 27.05.2022:

#### 1.Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

- a. Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe burimeve njerëzore në TIK.
- b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit.

#### 2.Auditimi i zhvillimit dhe i blerjes në Teknologjinë e Informacionit

- a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime.
- b. Procedurat e Investimeve në fushën TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të shërbimit.

#### 3.Auditimi i Sigurisë së Informacionit

- a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit.
- b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet.

#### 4.Auditimi i Sistemeve

- a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/output.
- b. Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre.

#### ***II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar***

Universitetet synojmë të formojmë dhe të përgatisim, studentë premtues, profesionistë e cilësorë në përshtatje me trendin e tregut të punës, shkencetarë në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin kombëtar por edhe në atë europian e më gjerë, duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore. Misioni i Universiteteve është i orientuar në këto drejtime:

- Të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe kërkimit.
- Të sigurojë mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme për studentët, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
- Të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të Shqipërisë dhe më gjerë.
- Të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit

#### ***II.5 Përgjegjësitë e audituesve***

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Universitetin e Tiranës, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 31.12.2021, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 468/3, datë 27.05.2022 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve

#### ***II.6 Kriteret e vlerësimit***

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikën më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

*Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165)
- Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar
- Ligji Nr. 162 Date 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.
- Ligji Nr 10296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore të zbatimit të tij.
- Ligji Nr 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”
- Legjislacioni mbi krimin Kibernetikë.

- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”.
- Ligji Nr 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
- Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik (Ndryshuar Me Vendimin Nr. 710, Datë 24.11.2021)
- Vendimi nr. 914, datë 29.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të Dhënave Shtetërore
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- Standardet TIK;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar;

## ***II.7 Standardet e auditimit***

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj

## ***II.8 Metodat e auditimit***

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Universitetin e Tiranës, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;

## ***II.9 Dokumentimi i auditimit***

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### ***III.1 Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim***

Universiteti i Tiranës është themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 207, datë 30.05.1957, Universiteti i Tiranës është universiteti më i madh publik në vend. Ai përbëhet nga 6 fakultete dhe 2 institute, ka 174 programe në të tre ciklet e studimit, staf akademik të brendshëm me kohë të plotë 779 pedagogë dhe rreth 23551 studentë.

Misioni i Universitetit është i orientuar në këto drejtime:

- Të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe kërkimit.
  - Të sigurojë mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme për studentët, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
  - Të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të Shqipërisë dhe më gjerë.
  - Të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit.
- Organi kolegjal më i lartë akademik i UT-së, është Senati Akademik, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij;
- Autoriteti më i lartë akademik i UT-së, është Rektori, i cili përfaqëson ligjërisht UT-në për çështjet akademike dhe protokollare; Rektorati është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga: Rektori; Zëvendësrektorët; Administratori i institucionit; Drejtuesit e njësive kryesore;
  - Dekani i fakultetit/drejtori i institutit kërkimor-shkencor, i cili është autoriteti më i lartë akademik i njësive kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësive kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
  - Bordi i Administrimit të UT-së, është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij;
  - Administratori i UT-së është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative;

Administratori i njësive kryesore (fakultet/institut), është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj

#### **III.2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:**

##### **III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK**

###### **a. Verifikimi i procedurave dhe burimeve njerëzore në TIK**

Universiteti i Tiranës përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Njësitë kryesore janë fakultetet dhe institutet e kërkimit shkencor, ndërsa njësitë bazë të tij janë departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore. Njësitë e tjera janë struktura të krijuara nga Universiteti në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit, të cilat ndihmojnë në përmbushjen e misionit të Universitetit. Njësitë e tjera janë njësi ndihmëse me karakter akademik, si dhe njësi ndihmëse me karakter administrativ, të cilat veprojnë në nivel rektorati dhe njësie kryesore. Njësitë ndihmëse që veprojnë në nivel rektorati përcaktohen në Statut. Njësitë ndihmëse që veprojnë në nivel njësie kryesore përcaktohen në rregulloret përkatëse të tyre.

Universiteti i Tiranës përbëhet nga 8 njësi kryesore, njësitë bazë dhe njësitë e tjera, si më poshtë:

- Fakulteti i Gjuhëve të Huaj;
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
- Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë;
- Fakulteti i Drejtësisë;
- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Shkencave Sociale;
- Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar;
- Instituti i Studimeve Evropiane;
- Filiali i Universitetit të Tiranës, Sarandë;
- Departamenti i Edukimit Fizik dhe i Sporteve Universitare.

Fakulteti ka personalitetin e tij juridik, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Statuti. Drejtuesi i fakultetit është dekan. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i fakultetit dhe përfaqësuesi i tij. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe të organeve kolegjiale të fakultetit dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.

Instituti është njësi kryesore e UT-së, i cili kryen veprimtari kërkimore-shkencore zhvillimi dhe inovacioni, në varësi të misionit përkatës të tij dhe strukturës përbërëse.

UT funksionin në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

- ❖ Në mbështetje të nenit 33 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, universiteti nxjerr Statutin dhe rregulloren e institucionit të arsimit të lartë. Në UT është miratuar me Vendimin nr. 4, datë 24.01.2022 e Rektoratit “Për Miratimin në parim të rregullores së brendshme të punës “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT-së””.

## **Verifikimi i strategjisë, politikave dhe burimeve njerëzore në TIK**

### **Strategjia TIK**

“Plani strategjik i zhvillimit të institucionit” është dokumenti ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësive përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre. Në UT me anë të vendimit nr. 15, datë 21.06.2018 të Senatit Akademik është miratuar “Propozim i plani strategjik të zhvillimit të Universitetit të Tiranës”. Ky plan strategjik përcakton parimet udhëzuese për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit dhe liston masat bazë që duhet të merren në mënyrë që UT-ja të përballojë sfidat e së ardhmes, si dhe përcakton linjat themelore të veprimit dhe krijon kornizën kuadër për performancën e Universitetit të Tiranës për vitet 2018-2023.

Fushëveprimi i këtij plani strategjik shtrihet në:

- Mësimdhënia dhe studimet;
- Ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti;
- Kërkimi shkencor;
- Angazhimi shoqëror;
- Personeli dhe infrastruktura;
- Financimi.

Për secilën nga fushat e këtij plani strategjik janë përcaktuar Objektivat dhe Strategjitë e Zbatimit për disa prej tyre.

Për sa më sipër grupi i auditimit konstaton se në këtë strategji nuk ka të përfshirë elementë të Teknologjisë së Informacionit, gjithashtu UT nuk ka miratuar një plan strategjik ku të ketë të përfshirë edhe element të Teknologjisë së Informacionit

Nga auditimi u konstatua se UT nuk ka një plan strategjik për Teknologjinë e Informacionit, ku të evidentohen nevojat aktuale dhe merren në konsideratë ato të ardhshme të institucionit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve, duke marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës së IT, investimeve, modelin e ofrimit, burimet duke përfshirë stafin për të mbështetur objektivat e institucionit. Strategjia e IT duhet të përfaqësojë lidhjen e përbashkët midis objektivave të IT dhe atyre institucionale. Strategjia e IT duhet të jetë pjesë e strategjisë institucionale, por nga auditimi u konstatua se UT nuk e ka një të tillë, në kundërshtim me nenin 36, pika 3, të Statutit të UT.

#### ***Nga auditimi u konstatua se:***

-Universiteti i Tiranës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit ose përfshirje të saj në strategjinë institucionale, duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave.

#### ***Politikat dhe burimet njerëzore në TIK***

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit në UT, verifikoi Rregulloren e Brendshme të institucionit si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje, pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara si dhe nga praktikatat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

- ❖ Aktualisht, UT e ushtron aktivitetin e tij mbështetur në aktet ligjore në fuqi dhe rregulloren e brendshme miratuar me Vendimin nr. 4, datë 24.01.2022 e Rektoratit “Për Miratimin në parim të rregullores së brendshme të punës “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të UT-së””.

Për periudhën objekt auditimi UT e ushtron aktivitetin e tij mbështetur në aktet ligjore në fuqi dhe rregulloren e brendshme miratuar me Vendim nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, i ndryshuar me vendimet e Senatit Akademik, Nr. 26, datë 02.07.2015 “Rregullore e Universitetit të Tiranës”. Sipas kësaj rregulloreje Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë ka qenë pjesë e Administratës e përbërë nga Sektori i Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit dhe Sektori i Infrastrukturës dhe Asistencës Teknike.

- ❖ Struktura aktuale e Drejtorisë së Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave është i përbërë nga Drejtori i Drejtorisë, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Sektori i Inovacionit dhe Statistikës. Përshkrimet e punës për këtë drejtori janë përcaktuar në rregulloren e brendshme miratuar me Vendimin nr. 4, datë 24.01.2022 e Rektoratit “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të Universitetit të Tiranës”.

**Tabela nr. 1:** Struktura e Drejtorisë së Teknologjisë, Inovacionit dhe Statistikave për vitin 2022

| Nr.                                     | Emërtimi           | Nr. punonjës |
|-----------------------------------------|--------------------|--------------|
| 1                                       | Drejtor            | 1            |
| Sektori i Teknologjisë së Informacionit |                    | 3            |
| 2                                       | Përgjegjës Sektori | 1            |
| 3                                       | Specialist         | 2            |
| Sektori i Inovacionit dhe Statistikës   |                    | 3            |
| 4                                       | Përgjegjës Sektori | 1            |
| 5                                       | Specialist         | 2            |

**Burimi:** UT, përpunuar nga grupi i auditimit

Fakultetet që janë në varësi të Rektoratit kanë si strukturë IT Degët e Informacionit dhe Teknologjisë të ndara nëpër Fakultetesi më poshtë:

**Tabela nr. 2:** *Strukturat IT të ndara nëpër Fakultete*

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><i>Fakulteti i Gjuhëve të Huaj</i><br/> <i>Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ</i><br/> Dega e Informacionit dhe e Teknologjisë përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Kryetar Dege;</li> <li>b) Specialist për monitorimin e sistemit;</li> <li>c) Specialist i Teknologjisë Informatike.</li> </ul> | <p><i>Fakulteti i Shkencave Sociale</i><br/> <i>Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ</i><br/> Dega e IT dhe Informacionit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Kryetar Dege;</li> <li>b) Specialist për monitorimin e sistemit;</li> <li>c) Specialist i Teknologjisë Informatike.</li> </ul> |
| <p><i>Fakulteti i Drejtësisë;</i><br/> <i>Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ</i><br/> Dega e Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Kryetar Dege;</li> <li>b) Specialist IT;</li> <li>c) Specialist informacioni.</li> </ul>                                              | <p><i>Fakulteti i Ekonomisë;</i><br/> <i>Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ</i><br/> Dega e IT përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Kryetar Dege;</li> <li>b) Specialist web design;</li> <li>c) Specialist;</li> <li>d) Specialist IT portal.</li> </ul>                                   |
| <p><i>Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë;</i><br/> <i>Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ</i><br/> Dega e IT dhe Informacionit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Kryetar Dege;</li> <li>b) Specialist informacioni.</li> </ul>                                                                 | <p><i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës;</i><br/> <i>Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ</i><br/> Dega e IT përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Kryetar Dege;</li> <li>b) Specialist IT.</li> </ul>                                                                                          |
| <p><i>Instituti i Studimeve Evropiane;</i><br/> Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ ka vetëm 1 specialist IT.</p> <p><i>Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar;</i><br/> Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ ka vetëm 1 specialist IT.</p>                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <p><i>Filiali i Universitetit të Tiranës, Sarandë;</i><br/> Struktura Ndhmës Akademik me Karakter Administrativ ka vetëm 1 specialist IT.</p>                                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |

**Burimi:** UT, përpunuar nga grupi i auditimit

## ➤ Trajnimet

Trajnimi është një nga shtyllat e rëndësishme për menaxhimin e kapaciteteve. Personeli që ka akses në asetet dhe sistemet e teknologjisë së informacionit të Universitetit të Tiranës të jetë i vetëdijshëm për rregullat dhe standardet e sigurisë dhe të jenë të aftë t'i zbatojnë dhe ndjekin ato gjatë punës së tyre.

- Është e nevojshme që procesi të mbështetet në një identifikim dhe analizë të nevojave për trajnim të stafit, me qëllim që të sigurohet parashikimi, programimi dhe implementimi i suksesshëm i veprimtarive trajnuese.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Tiranës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitin 2020 dhe 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim. Duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

## ➤ Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK

Menaxhimi i riskut IT është aplikimi i metodave të menaxhimit të rrezikut në teknologjinë e informacionit për të menaxhuar rrezikun e TI-së, pra: Rreziku i institucionit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e IT në Universitetin e Tiranës. Nga administrimi i dokumentacionit sesi Universiteti i Tiranës identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se UT

nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. UT nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përse i përket arritjes së objektivave institucionale.

Nisur sa më sipër dhe mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Universiteti i Tiranës nuk dispononë regjistër risku ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

|                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.Titulli i gjetjes:</b> | Mungesë e planifikimit strategjik mbi teknologjinë e informacionit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Situata:</b>             | Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Tiranës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit ose përfshirje të saj në strategjinë institucionale, duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. |
| <b>Kriteri:</b>             | Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës.                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b>      | Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit.                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>Shkaku:</b>              | Mos zbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>Rëndësia:</b>            | E Lartë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>1.1.Rekomandimi</b>      | Universiteti i Tiranës të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, si dhe të marrë masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të përcaktuara.                                                                                                          |

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me nr. 1522/2 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/13, datë 07.12.2022, protokolluar në UT dhe me nr. 468/16, datë 07.12.2022 protokolluar në KLSH.*

***Pretendimi i subjektit:***

*.... Sa më sipër, Universiteti i Tiranës ka të miratuar “Strategji të zhvillimit të UT-së” për vitin 2018-2023. ....*

***Qëndrimi i Grupit të Auditimit:***

Grupi i auditimit sqaron se kjo strategji është gjithëpërfshirëse nuk ka objektiva të përcaktuara qartë si dhe një plan veprimi për teknologjinë e informacionit. Konstatimi i grupit të auditimit lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematikë, pa anashkaluar punën e bërë deri në këtë kohë nga ana e UT, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

|                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>2.Titulli i gjetjes:</b> | Mungesa e parashikimit dhe zhvillimit të trajnimeve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Situata:</b>             | Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Tiranës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2020 - 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim. Duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. |
| <b>Kriteri:</b>             | Përshkrimet e punës në strukturën e IT.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b>      | Risk në mos përmbushje të objektivave të përcaktuara.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Shkaku:</b>              | Mungesë planifikimi për zhvillimin e trajnime për burimet njerëzore.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Rëndësia:</b>            | E Lartë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>2.1.Rekomandimi:</b>     | Universiteti i Tiranës të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit i cili merret me administrimin e bazës së të dhënave dhe të çdo përdoruesi të sistemit, si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.                                                                                                                              |

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me nr. 1522/2 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/13, datë 07.12.2022, protokolluar në UT dhe me nr. 468/16, datë 07.12.2022 protokolluar në KLSH

***Pretendimi i subjektit:***

*Sa më sipër, për periudhën e auditimit vitet 2020-2021, duhet të mbajmë në konsideratë se janë vitet kur Shqipëria dhe jo vetëm, por mbarë bota vuajti pasojat e shkaktuara nga virusi Sars cov 19. ....*

***Qëndrimi i Grupit të Auditimit:***

*Grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim pasi trajnimet mund të bëhen edhe online gjatë situatave të tilla, si dhe duhet pasur parasysh që rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit fokus ka trajnimet e zhvilluara mbi teknologjinë e informacionit.*

|                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>3. Titulli i gjetjes:</b> | Identifikimi i risqeve në Teknologjinë e Informacionit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <b>Situata:</b>              | Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Tiranës nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përse i përket arritjes së objektivave institucionale. |
| <b>Kriteri:</b>              | Neni 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.                                                                                                                                                                 |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b>       | Mos identifikim, mos adresim i problematikave që mund të shfaqen, shkelje e sigurisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>Shkaku:</b>               | Mos zbatim i dispozitave ligjore.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Rëndësia:</b>             | E Lartë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

**3.1.Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të marr masa për hartimin e regjistrit të riskut ku të përfshihen edhe risqet për Teknologjinë e Informacionit me qëllim identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuar, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me nr. 1522/2 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/13, datë 07.12.2022, protokolluar në UT dhe me nr. 468/16, datë 07.12.2022 protokolluar në KLSH

**Pretendimi i subjektit:**

..... sikundër rezulton nga shkresa nr. 3488/1 prot., datë 20.01.2014 Grupi i Menaxhimit Strategjik ka hartuar Regjistrin e Riskut për UT-në, për periudhën 2014-2016, miratuar nga titullari i njësisë publike. ....

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim pasi për periudhën objekt auditimi nuk kishte një regjistrë risku për teknologjinë e informacionit.

## 2.Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit **nr.468/3, datë 27.05.2022**, “Auditimi i zhvillimit dhe i blerjes në Teknologjinë e Informacionit” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Lista e prokurimeve TIK të periudhës 01.01.2020 – 31.12.2021;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- 3- Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve
- 4- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- 5- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si auditues;

*Tabela nr.2.Regjistri i Realizimeve për vitin 2020*

| Nr. | Objekti i Prokurimit                          | Fondi Limit | Lloji i Procedurës së Prokurimit | Vlera e kontratës | Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit | Operatori Ekonomik i shpallur fitues |
|-----|-----------------------------------------------|-------------|----------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------|--------------------------------------|
| 1   | Blerje materiale të ndryshme                  | 166,667     | Small Value                      | 149,500           | 13/10/2020<br>12:30 PM                        | S                                    |
| 2   | Blerje pajisje elektronike                    | 47,689,948  | Open Local                       | 22,906,500        | 05/01/2021<br>10:00 AM                        | P.S                                  |
|     |                                               |             |                                  | 23,815,025        | 11/01/2021<br>10:00 AM                        | P.S                                  |
| 3   | Mirembajtje e zakonshme pajisjesh elektronike | 10,764,167  | Open Local                       |                   | 29/12/2020<br>10:00 AM                        |                                      |
| 4   | Sherbim faqe Interneti                        | 333,333     | Small Value                      | 155,500           | 16/09/2020<br>09:00 AM                        | S.S                                  |

Tabela nr.3. Regjistri i Realizimeve për vitin 2021

| Nr. | Objekti i Prokurimit                                                                                            | Fondi Limit | LLoji i Procedures se Prokurimit | Vlera e kontratës | Data e zhvillimit te procedures se prokurimit | Operatori Ekonomik i shpallur fitues |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|----------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------|--------------------------------------|
| 1   | Blerje pajisje elektronike dhe Paisje audiovizive                                                               | 53,117,500  | Open INT                         | 39,304,080        | 23/12/2021<br>11:00 AM                        | S                                    |
|     |                                                                                                                 |             |                                  | 12,275,100        | 23/12/2021<br>11:00 AM                        | S                                    |
| 2   | Blerje Pajisje per Laborator perkthimi dhe interpretimi ne FGJH                                                 | 14,751,402  | Open Local                       | 14,560,000        | 25/10/2021<br>11:00 AM                        | P.S                                  |
| 3   | F.V i rrjetit te Internetit, Servera dhe Faqe web per sherbimin studentor FSHN                                  | 12,070,833  | Open Local                       | 11,949,140        | 10/02/2022<br>11:00 AM                        | P.S                                  |
| 4   | Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT                                                            | 2,402,100   | Open Local                       | 2,402,100         | 03/08/2021<br>12:00 AM                        | D                                    |
|     |                                                                                                                 | 2,695,800   | Open Local                       | 2,695,800         | 11/11/2021<br>12:00 AM                        | D                                    |
| 5   | Shpenzime mirembajtje te tjera të pa përfshira më sipër                                                         | 166,667     | Small Value                      | 164,999           | 29/09/2021<br>01:00 PM                        | S.S                                  |
| 6   | Zhvillimi i infrastrukturës në shërbim të kërkuesve të rinj dhe studentëve per Fakultetin e Gjuheve te Huaja-UT | 20,863,598  | Open Local                       | 19,871,100        | 16/12/2021<br>11:00 AM                        | P.S                                  |

Burimi Universiteti i Tiranës

Grupit i auditimit ka analizuar regjistrat e investimeve TIK të përfunduara në periudhën e auditimit 2020 - 2021 ku rezulton se, janë realizuar gjithsej **10** procedura me fond limit (FL) në vlerën **165,022,015 lekë pa TVSH**, . Nga audimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka një mire planifikim për realizimin e procedurave TIK të parashikuara.

**Për vitin 2020**, janë realizuar gjithsej 4 procedura në shumën **58,954,115 lekë pa TVSH**, ku: 2 procedura tenderimi për shërbime, mallra në shumën **58,454,115 lekë pa TVSH**; 2 procedura “Blerje me vlerë të vogël” në shumën **500,000 lekë pa TVSH**;

- “Procedurë e hapur” 2 procedura, me fond limit (FL) **58,454,115 lekë pa TVSH**, kontrata të lidhur pa TVSH në shumën **46,721,525 lekë**, me kursim të fondeve në shumën **11,732,590 lekë** ose **20 %** më poshtë fondit limit.

- “Blerje me vlerë të vogël” gjithësej 2 procedura, me fond limit (FL) **500,000 lekë pa TVSH**, kontrata të lidhura pa TVSH në shumën **305,000 lekë**, me kursim të fondeve në shumën **195,000 lekë pa TVSH** ose **39 %** më poshtë se fondi limit;

**Për vitin 2021**, janë realizuar gjithsej 6 procedura në shumën **106,067,900 lekë pa TVSH**, nga ku: 5 procedura për shërbime, mallra në shumën **105,902,901 lekë pa TVSH**; 1 procedure , “Blerje me vlerë të vogël” në shumën **164,999 lekë pa TVSH**;

- “Procedurë e hapur” 4 procedura, me fond limit (FL) **52,783,733 lekë pa TVSH**, kontratë të lidhur pa TVSH në shumën **51,478,140 lekë**, me kursim të fondeve në shumën **1,305,593 lekë** ose **2.4 %** më poshtë se fondi limit.

- “Procedurë e hapur ndërkombëtare”, 1 procedurë, me F.L. **53,117,500 lekë pa TVSH**, kontrata të lidhura pa TVSH në shumën **51,579,180 lekë**, me kursim të fondeve në shumën **1,538,320 lekë pa TVSH** ose **2.8 %** më poshtë se fondi limit.

-“Blerje me vlerë të vogël” gjithsej 1 procedurë, me fond limit (FL) **166,667 lekë pa TVSH**, kontrata të lidhura pa TVSH në shumën **164,999 lekë pa TVSH**, me kursim të fondeve në shumën **1,668 lekë pa TVSH** ose **1 %** më poshtë se fondi limit.

**1.Titulli i Gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se Inicimi i procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor në dosjet e prokurimit të procedurave TIK për periudhën 01.01.2020- 31.12.2021 nuk përmbajnë argumentim të nevojës për kryerjen e këtyre investimeve si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës, në të cilin të jetë parashikuar kryerja e këtyre investimeve / shpenzimeve, për nevojat e Universitetit, evidentuar të paktën në 7 raste.

**Situata:** Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit publik të Teknologjisë së Informacionit :

- 1) Procedura Blerje pajisje Elektronike, softje për përpunimin e të dhënave cilësore programe software, aplikacion për studentët, , sistem kamerash”
- 2) “Blerje pajisje elektronike dhe audiovizuale për UT
- 3) ”Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2020.
- 4) Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2021
- 5) Blerje pajisje për laborator përkthimi dhe interpretimi në FGJH”
- 6) “Blerje pajisje për laboratorë didaktikë në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës në shërbim të fuqizimit të kërkuesve të rinj dhe të studentëve në FGJH
- 7) F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN

Kërkesat për fillimin e këtyre procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor nuk përmbajnë asnjë argumentim të nevojës së Universitetit, për realizimin e këtyre prokurimeve, si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës në të cilin të jetë është parashikuar kryerja e këtyre investimeve/shpenzimeve, jo në përputhje të plotë me kërkesat e e nenit 12, pika 2, gërma a) të ligjit Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar,

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, 'Për Prokurimin Publik', i ndryshuar VKM 914 datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ‘Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik’

**Ndikimi/Efekti:** Mosevidentim i saktë i nevojave për investime dhe shpenzime të Universitetit të Tiranës sipas planeve ekonomike të saj,

**Shkaku:** Mosnjohje dhe mosvlerësim i duhur i Legjislacionit të Prokurimit Publik

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit, t'i iniciojë këto procedura duke evidentuar kërkesat nga e Universitetit, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime.

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Projekt Raportit të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4,5,6, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me nr. 1522/4,1522/5, 1522/6 datë 30.09.2022, mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr468/4,468/5,468/6. datë 10.10.2022 nga KLSH.*

***Pretendimi i subjektit:***

*Në lidhje me konstatimin e audituesve se: "... nuk ka një kërkesë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi", sqarojmë se, çdo shpenzim i kryer në Universitetin e Tiranës, është pjesë e Buxhetit të Miratuar nga organet më*

të lana vendimmarrëse, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të UT-së. Ndaj kërkesa dhe arsyeja e domosdoshmërisë së kryerjes së këtij shpenzimi është në Buxhetin e çdo njësie shpenzuese, dhe automatikisht është parashikuar edhe në Buxhetin e Konsoliduar të Universitetit të Tiranës. Buxhetet e të gjitha njësive shpenzuese të UT-së për periudhën e audituar janë vënë në dispozicion Grupit të Auditimit.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit i qëndron opinionit se kërkesat inicimin e realizimit të procedurave të prokurimit nuk përmbajnë asnjë argumentim të nevojës së Universitetit të Tiranës për realizimin e prokurimit, dhe nuk përmbajnë një përshkrim të shërbimeve që prokurohen

### ➤ **Procedura e prokurimit “Blerje pajisje Elektronike, softje për përpunimin e të dhënave cilësore programe software, aplikacion për studentët, sistem njoftimi, sistem kamerash”, i ndarë në 2 lote ,viti 2020**

Të dhëna të përgjithshme të procedurës (Loti 1)

|                                                                                       |                                                                                                               |                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Urdhër prokurimi, nr 76.dt</b><br>09.12.2020                                       | <b>Hartuesit e specifikimeve Teknike</b><br>1. B.ZH (p.sektori)<br>2. R.H (Specialist IT<br>3. D.K Specialist | <b>Komisioni i Vlerësimit të ofertave</b><br>1. E.Q (Kryetar)<br>2. E.S (anëtar)<br>3. E.T (anëtar) |
| Fondi Limit Loti 1 : 23,245,674                                                       |                                                                                                               |                                                                                                     |
| <b>Procedura e prokurimit –</b><br>Procedurë e hapur                                  |                                                                                                               |                                                                                                     |
| <b>Datë e hapjes së tenderit</b><br>05.01.2021                                        | <b>Njësia e Prokurimit</b><br>1. E.T<br>2. D.K<br>3. M.P                                                      | <b>. Operatorë të skualifikuar</b><br>1.D.S”<br>2.“D”                                               |
| <b>Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:</b><br>1. P.S shpk<br>2. D.S”<br>3. D” | <b>Operatore te Kualifikuar:</b><br>1.P.Sshpk<br><br><b>Operatori Fitues:</b> P.Sshpk                         | <b>Vlera e kontratës</b> 22,906,500                                                                 |
| <b>Ankimime në AK per vleresim-PO</b>                                                 | <b>Diferenca nga fondi limit.</b><br>339,174                                                                  | <b>Afati kontratës</b> 90 dite nga data e nëshkrimit të kontratës.                                  |

#### **Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se nuk ka një kërkesë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi,

Në bazë të urdhrit nr.45, datë 05.10.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt LOTI 1 - "F.V. Blerje pajisje elektronike, softje për përpunimin e të dhënave cilësore, programe software, aplikacion për studentët, sisteme njoftimi etj.", më datë 07.12.2020 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit.

-Në datën 09.12.2020 u mblodh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.76, datë 09.12.2020, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Kriteret e veçanta të kualifikimit ,pika 2.4 :

- 1 (një) specialist të çertifikuar për softearin Desktop Gis ose ekuivalent;

Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa për operatorët ekonomikë për të patur Specialist të certifikuar për softuerin Desktop Gis është e pa nevojshme pasi nga AK është kërkuar instalimin e Licensave GIS dhe jo përdorimi i tij.

*1 (një) specialist të certifikuar për sistemin e menaxhimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet në nivel CCNP ose ekuivalent;*

Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa për operatorët ekonomikë për të patur një specialist të certifikuar me Cisco Certified Network Professional (CCNP) në një procedurë furnizim me mallra ku pajisjet e rrjetit janë Switch ,firewall është e panevojshme pasi instalimi i këtyre pajisjeve mund të kryet dhe nga 1 specialist me eksperiencë të certifikuar në pajisje rrjeti në nivel më të ulët.

Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : *“Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 ‘Kërkesat e cilësisë’ të VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar në të cilin citohet se : “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit” dhe pikën 3 të Nenit 46 ‘Kualifikimi i ofertuesve’ të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.”*

### **Ankesa për Dokumentet e Tenderit**

-Lidhur me kriteret për kualifikim të Dokumenteve të Tenderit në datën 15.12.2020 pranë AK është paraqitur ankesë për lotin 1 nga operatori ekonomik "I" shpk. Me urdhrin e Titullarit të AK-së nr.77/1, datë 17.12.2020 është pezulluar procedura e prokurimit për shqyrtimin e ankesës. Anëtarët e KSHA-së, pasi shqyrtuan pretendimet e ngritura nga ankuesi i sipërcituar kanë vendosur të refuzojnë ankesën e OE "I" shpk, duke i kthyer përgjigje më datë 17.12.2020.

-Në datën 30.12.2020 janë vënë në dijeni nga OE "I" shpk për dorëzim ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe më datë 31.12.2020 janë vënë në dijeni me Vendimin e KPP-së nr.610/2020 për mos pranim të ankesës për tejkallim të afateve të ankimimit.

Titullari i AK-së nxjerr vendimin për heqjen e pezullimit të bërë me urdhrin nr.77/1 datë 17.12.2020 dhe vazhdimin e procedurës për Lotin 1.

### **Zhvillimi i Procedurës**

Në datën e caktuar për hapjen e ofertave me 05.01.2021, në orën 10:00 një nga anëtarët e NJP .Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur interes duke dorëzuar ofertat ekonomike dhe dokumentacionin administrativo-ligjor operatorët ekonomikë si më poshtë:

1. "P" shpk, me vlerë 22,906,500.00 lekë pa TVSh.
2. "D AL" Degë e Shoqërisë së Huaj, me vlerë 23,022,500.00 lekë pa TVSh..
3. "D" shpk, me vlerë 0.00 lekë pa TVSh.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, të dokumentacionit administrativo-ligjor, të specifikimeve teknike dhe mostrave, të ofertave të paraqitura për këtë procedurë rezultoi se, 2 operatorë ekonomikë nuk plotësonin kërkesat e vendosura në DT, e konkretisht;

1. OE "DA " Degë e Shoqërisë së Huaj, nuk plotëson kriteret e DT, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, si më poshtë: - Nuk plotëson kriteret e përgjithshme të Pranimit / Kualifikimit .nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar,

2. OE "D" shpk, nuk plotëson kriteret e DT, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, si më poshtë:

-Nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit,. nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar,

Të dhëna të përgjithshme të procedurës (Loti 2)

|                                                                                        |                                                                                                                   |                                                                                                         |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Urdhër prokurimi,</b><br>76.dt 09.12.2020                                           | <b>Hartuesit e specifikimeve Teknike</b><br><br>1. B.ZH (p.sektori)<br>2. R.H (Specialist IT<br>3. D.K Specialist | <b>Komisioni i Vlerësimit të ofertave</b><br><br>1. E.Q (Kryetar)<br>2. E.S (anëtar)<br>3. E.T (anëtar) |
| Fondi Limit Loti 2 : 24,166,666                                                        |                                                                                                                   |                                                                                                         |
| <b>Procedura e prokurimit</b> –<br>Procedurë e hapur                                   |                                                                                                                   |                                                                                                         |
| <b>Datë e hapjes së tenderit</b><br>11.01.2021                                         | <b>Operatori Fitues:</b> P.Sshpk                                                                                  | <b>Operatorë të skualifikuar</b><br>“E” shpk<br>B” shpk,                                                |
| Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>1.”P” Shpk<br>2 “E” shpk<br>3 “B” shpk, | <b>Operatore te Kualifikuar:</b><br>1. P.Sshpk                                                                    | <b>Vlera e kontratës</b> 23,815,025                                                                     |
| <b>Ankimime në AK per vleresim-PO</b>                                                  | <b>Diferenca nga fondi limit.</b><br>351,641                                                                      | <b>Afati kontratës</b> 90 dite nga data e nëshkrimit të kontratës.                                      |

### **Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Në bazë të urdhrit nr.45, datë 05.10.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit te kontratës me objekt LOTI 2-“ F.V. Sistem kamerash ", më datë 07.12.2020 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit.

-Në datën 09.12.2020 u mbledh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.76, datë 09.12.2020, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Lidhur me kriteret për kualifikim të Dokumenteve të Tenderit në datën 16.12.2020 pranë AK është paraqitur ankesë për lotin 2 nga operatori ekonomik "B " shpk.

Me urdhrin e Titullarit të AK-së nr.77/1, datë 17.12.2020 është pezulluar procedura e prokurimit për shqyrtimin e ankesës.

Anëtarët e KSHA-së, pasi shqyrtuan pretendimet e ngritura nga ankuesi kanë vendosur të pranojnë pjesërisht ankesën e OE "B" shpk për të bërë modifikimet e nevojshme, dhe i është kthyer përgjigje më datë 18.12.2020.

Në zbatim të vendimit të Titullarit të AK-së datë 18.12.2020 mbi shqyrtimin e ankesave dhe mbështetur në nenin 42 te LPP-se, Njësia e Prokurimit ka modifikuar specifikimet teknike të DT për lotin 2. duke hedhur më datë 23.12.2020 në SPE shtojcën për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar.

Më datë 30.12.2020 Titullarit të AK-së nxjerr vendimin për heqjen e pezullimit të bërë me urdhrin nr.77/1 datë 17.12.2020 në përfundim të afateve të ankimit, si dhe lejimin e vazhdim të procedurës për Lotin 2. Njësia e Prokurimit më datë 30.12.2020 bën njoftimin për ndryshimin e afatit të hapjes së ofertave për lotin 2 nga data 05.01.2021, për në datën 11.01.2021. Më datë 30.12.2020 dhe 05.01.2021 në SPE janë paraqitur kërkesa për sqarim mbi DT loti 2, për të cilat Njësia e Prokurimit u ka kthyer përgjigje operatorëve ekonomik të interesuar sqarimet

Për këtë procedurë prokurimi kanë dorëzuar ofertat ekonomike dhe dokumentacionin administrativo-ligjor operatorët ekonomikë si më poshtë:

1. "P.S" shpk, me vlerë 23,815,025.00 lekë pa TVSh.

2. "E" shpk, me vlerë 00.00 lekë pa TVSh. 3. "B" shpk, me vlerë 00.00 lekë pa TVSh.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, të dokumentacionit administrativo-ligjor, të specifikimeve teknike, të ofertave të paraqitura për këtë procedurë rezultoi se, 2 operatorë ekonomike nuk plotësonin kërkesat e vendosura në DT, e konkretisht:

1. OE "E" shpk, nuk plotëson kriteret e DT, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, si më poshtë:

Nuk plotëson kriteret e përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, pikat a, b, c, ç, d. Nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pikën 2.1 gërmat a, b, c, d, dh, e. Nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar, pikën 2.3. gërmat a, b. 2. OE "B" shpk, nuk plotëson kriteret e DT, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, si më poshtë:

Nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar, pikën 2.3. gërmat a, b. Nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapacitetin teknik, pikën 2.4, gërmat a, b, c, d,e, f, g, h, i.

Plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim në përputhje me specifikimet teknike, duke kualifikuar operatorin ekonomik si më poshtë: 1. "P.S" shpk, me vlerë 23,815,025.00 lekë pa TVSh.

KVO në përfundim të zhvillimit të procedurës dhe të afatit të ankimimit, si dhe mbështetur në nenin 68 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i propozon Titullarit të AK miratimin e procedurës me objekt LOTI 2 - "F.V. Sistem kamerash" dhe shpalljen si fitues të saj operatorin ekonomik "P.S" shpk, me vlerë 23,815,025 lekë pa TVSh

### **“Blerje pajisje elektronike dhe audiovizuale për UT**

Të dhëna mbi objektin: "Loti 1: Blerje pajisje elektronike"

|                                                                                    |                                                                                   |                                                                                                   |
|------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Urdhër prokurimi</b> , Nr,85 datë 10.11.2021<br>Fondi Limit Loti 1 : 40,417,448 | <b>Hartuesit e specifikimeve Teknike</b><br>1.M.P ,FGJH<br>2.E.C IT,FHF<br>3. V.C | <b>Komisioni i Vlerësimit të ofertave</b><br>1.E.Q (Kryetar)<br>2. G.K (anwtar)<br>3.A.S (anëtar) |
| <b>Procedura e prokurimit</b> – Procedurë e hapur                                  |                                                                                   |                                                                                                   |
| <b>Datë e hapjes së tenderit</b> 23.12.2021                                        | <b>Njesia e Prokurimit</b><br>1. E.T<br>2. S.L<br>3. D.K                          | <b>Operatorë të skualifikuar</b><br>1..”P.S“shpk                                                  |
| Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>1.”S” shpk<br>2.”P.S“shpk           | <b>Operatore te Kualifikuar:</b><br>1. .”S shpk<br><b>Operatori Fitues: S</b>     | <b>Vlera e kontratës</b> 39,304,080                                                               |
| <b>Ankimime</b> në AK per vleresim- JO                                             | <b>Diferenca nga fondi limit.</b><br>1,113,368                                    | <b>Afati kontratës</b> 90 dite nga data e nëshkrimit të kontratës.                                |

### **Mbi realizimin e procedurës së prokurimit**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se nuk ka një kërkesë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi,

- Në bazë të urdhrat nr.47, datë 27.09.2021 Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt "Blerje pajisje

elektronike dhe audiovizuale për UT" më datë 08.11.2021 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit.

Në datën 19.11.2021 u mbledh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.85, datë 10.11.2021, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Njoftimi i Kontratës dhe dokumentet e këtij tenderi u publikuan në faqen e SPE të APP-së në datën 22.11.2021, ndërsa në buletin zyrtar të njoftimeve publike u shpall në datën 01.12.2021. Lidhur me kriteret për kualifikim të Dokumenteve të Tenderit nuk është paraqitur asnjë ankesë. Me urdhrin e Titullarit të AK-së nr.86/1, datë 02.12.2021 është pezulluar procedura e prokurimit me inisiativën e Njesisë së prokurimit, e cila ka modifikuar DT nëpërmjet shtojcës nr.1, datë 02.12.2021.

*Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit - Kapaciteti ekonomik dhe financiar - pika 2.2.1 nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se kriteri i vendosur për 1 (një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimin e shërbimeve të suportit dhe garancisë, objekt i këtij prokurimi. është e panevojshme pasi procedura e kërkuar është për blerje pajisje elektronike dhe jo për implementim projekti*

*Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se : "Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 'Kërkesat e cilësisë' të VKM 285, Datë 19.05.2021 'Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', ndryshuar në të cilin citohet se : "Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit"*

. Për këtë procedurë dorëzuan ofertat në sistemin elektronik të APP-së operatorët ekonomikë, si më poshtë:

1. OE "S" shpk, me vlerë të ofertës prej 39,304,080 lekë pa TVSh;

2. OE "P.S" shpk, me vlerë të ofertës prej 39,587,140 lekë pa TVSh Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, të dokumentacionit administrativo-ligjor dhe financiar, të 2 ofertave të paraqitura për këtë procedure rezulton si më poshtë:

1. "S" shpk i plotëson të gjitha kriteret e DT.

Për këtë arsye, referuar nenit 92, pikës 3 të LPP-së ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji....", KVO ka vendosur ta pranojë ofertën e OE të mësipërm

2. "P.S" shpk nuk i plotëson të gjitha kriteret e DT, për arsyet si më poshtë:

Nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pikën 2.3.3, pasi nuk disponon numrin e punonjësve kryesorë të kualifikuar sipas kërkesës së kësaj pike. Si dhe nuk ka paraqitur certifikatat mbështetëse të kërkuara për punonjësit.

Nuk plotëson Kriteret e tjera të Veçanta të Kualifikimit, pikën 2.4.2, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, për pajisjet objekt prokurimi.

Nuk plotëson Kriteret e Tjera të Veçanta të Kualifikimit, pikën 2.4.3, pasi nuk ka paraqitur fotografi/kataloge/broshurë ose fragmente (faqe) të katalogatëve, për pajisjet objekt prokurimi.

.Në përfundim të gjithë procesit të vlerësimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, KVO rendit ofertat e vlerësuara të vlefshme, si më poshtë:

1. OE" S" shpk, me vlerë të ofertës prej 39,304,080 lekë pa TVSh.

KVO është mbledhur për të verifikuar ofertën në formë të shkruar të paraqitur për lotin 1 nga operatori ekonomik i renditur i pari "S" shpk, dorëzuar me shkresën protokolluar me nr.prot.2513/6, datë 12.01.2022.

Lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave për lotin 1 brenda afatit ligjor ankimor nuk ka patur ankesë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.

KVO në përfundim të zhvillimit të procedurës, si dhe mbështetur në nenin 84 të VKM nr.258, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i propozon Titullarit të AK miratimin e procedurës me objekt "Loti 1: Blerje pajisje elektronike" dhe shpalljen si fitues të saj operatorin ekonomik "S" shpk, me vlerë 39,304,080 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e katër mijë e tetëdhjetë) lekë pa TVSh.

## **Blerje pajisje elektronik dhe audiovizuale për UT" Loti 2**

Të dhëna mbi objektin: "Loti 2: Blerje pajisje audiovizuale për UT"

|                                                                           |                                                                                                           |                                                                                                   |
|---------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Urdhër prokurimi,</b> Nr.85 datë 10.11.2021                            | <b>Hartuesit e specifikimeve Teknike</b><br>1.M.P<br>2.E.Ç<br>3. V.C                                      | <b>Komisioni i Vlerësimit të ofertave</b><br>1.E.Q (Kryetar)<br>2. G.K (anëtar)<br>3.A.S (anëtar) |
| Fondi Limit Loti 1 : 12,691.380                                           |                                                                                                           |                                                                                                   |
| <b>Procedura e prokurimit</b> – Procedurë e hapur                         |                                                                                                           |                                                                                                   |
| <b>Datë e hapjes së tenderit</b> 23.12.2021                               | <b>Operatore të Kualifikuar:</b><br>1. ."S" shpk<br>2. ."P.S" shpk<br><b>Operatori Fitues:</b> Sinteza CO | <b>Operatorë të skualifikuar</b><br>Nuk ka                                                        |
| Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>1."S" shpk<br>2."P.S" shpk | <b>Njesia e Prokurimit</b><br>1. E.T<br>2. S.L<br>3. D.K                                                  | <b>Vlera e kontratës</b> 12,275,100                                                               |
| <b>Ankimime në AK per vleresim- JO</b>                                    | <b>Diferenca nga fondi limit.</b><br>416,280                                                              | <b>Afati kontratës</b> 90 dite nga data e nënshkrimit të kontratës.                               |

### **Mbi realizimin e procedurës së prokurimit**

Në bazë të urdhrit nr.47, datë 27.09.2021 Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt "Blerje pajisje elektronik dhe audiovizuale për UT" më datë 08.11.2021 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit.

Në datën 19.11.2021 u mblodh Njesia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.85, datë 10.11.2021, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Njoftimi i Kontratës dhe dokumentet e këtij tenderi u publikuan në faqen e SPE të APP-së në datën 22.11.2021, ndërsa në buletin zyrtar të njoftimeve publike u shpall në datën 01.12.2021. Lidhur me kriteret për kualifikim të Dokumenteve të Tenderit për lotin 2 nuk është paraqitur asnjë ankesë. Me urdhrin e Titullarit të AK-së nr.86/1, datë 02.12.2021 është pezulluar procedura e prokurimit me iniciativën e Njesisë së prokurimit, e cila ka modifikuar DT nëpërmjet shtojcës nr.1, datë 02.12.2021.

Për këtë procedurë dorëzuan ofertat në sistemin elektronik të APP-së operatorët ekonomikë, si më poshtë:

1. OE "S " shpk, me vlerë të ofertës prej 12,275,100 lekë pa TVSh;
2. OE "P.S" shpk, me vlerë të ofertës prej 12,387,000 lekë pa TVSh

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, të dokumentacionit administrativo-ligjor dhe financiar, të 2 ofertave të paraqitura për këtë procedurë rezulton si më poshtë:

1. "S" shpk, i plotëson të gjitha kriteret e DT.

Referuar nenit 92, pikës 3 të LPP-së ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e

tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji....", KVO ka vendosur ta pranojë ofertën e OE të mësipërm

2. "P.S" shpk, i plotëson të gjitha kriteret e DT.

Referuar nenit 92, pikës 3 të LPP-së ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor. në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji....", KVO ka vendosur ta pranojë ofertën e OE të mësipërm

Në përfundim të gjithë procesit të vlerësimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, KVO rendit ofertat e vlerësuara të vlefshme, si më poshtë:

1. OE "S" shpk, me vlerë të ofertës prej 12,275,100 lekë pa TVSh;

2. OE "P.S" shpk, me vlerë të ofertës prej 12,387,000 lekë pa TVSH..

Në datën 14.01.2022 është bërë publikimi i njoftimit paraprak i OE fitues për lotin 2 S shpk, ndërsa në buletin e njoftimeve publike u shpall në datën 24.01.2022.

Lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave për lotin 2 brenda afatit ligjor ankimor nuk ka patur ankesë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.

Për sa më sipër, KVO në përfundim të zhvillimit të procedurës, si dhe mbështetur në nenin 84 të VKM nr.258, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i propozon Titullarit të AK miratimin e procedurës me objekt "Loti 2: Blerje pajisje audiovizuale" dhe shpalljen si fitues të saj operatorin ekonomik "S" shpk, me vlerë 12,275,100 (dymbëdhjetë milion dyqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e njëqind) lekë pa TVSh.

#### ➤ **Procedura me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT" viti 2020**

|                                                                       |                                                          |                                                                             |
|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| <b>Urdhër prokurimi</b> , nr 67, datë 27.11.2020                      | Hartuesit e specifikimeve Teknike dhe fondi limit        | <b>Komisioni i Vlerësimit të ofertave</b>                                   |
| Fondi Limit : 10,759,400 Lekë pa tvsh                                 | 1. A.H<br>2. E.U<br>3. D.K                               | 1. E.Q<br>2. Y.C<br>3. D.K                                                  |
| <b>Procedura e prokurimit</b> – Procedurë e hapur -Marrëveshje kuadër |                                                          |                                                                             |
| <b>Datë e hapjes së tenderit</b><br>29.12.2022                        | <b>Njësia e Prokurimit</b><br>1. E.T<br>2. E.S<br>3. M.P | Komisioni i ngarkuar për zbatimin e kontratës<br>1. R.H<br>2. D.K<br>3. K.D |
| Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>1. "D" shpk            | <b>Operatore të Kualifikuar:</b><br>4. "D" shpk          | <b>Operatorë të s kualifikuar</b><br>Nuk ka                                 |
| <b>Ankimime në AK për vlerësim- jo</b>                                | <b>Vlera e kontratës</b><br>1,284,300 Lekë për njësi     |                                                                             |

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se nuk ka një kërkesë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi.

-Në bazë të urdhrit nr.67, datë 27.11.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT", më datë 02.12.2020 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit. Sipas specifikimeve Teknike ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Shumatorja e çmimeve për njësi të OE, nuk duhet të kalojë

shumatoren e çmimeve për njësi të publikuar në DT, në të kundërt oferta do të refuzohet; Vlera e pritshme e kontratave nuk duhet të kalojë fondin limit të MK (vlerën e pritshme të kontratave) të publikuar në DT. Nga dokumentacioni i audituar AK i ka dërguar ftesë për ofertë vetëm 1 operatori :“D”shpk

Në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës nder të tjera janë kërkuar

- *Shërbim mirëmbajtje dhe kontroll periodik (pastrim nga viruset)*
- *Shërbim update antivirusi dhe sistemi operativ*
- *Shërbim Instalim/konfigurim/update firmware*
- *Shërbim update firmware*
- *Shërbim mirëmbajtje sistemi operativ për ekranin ndërveprues*
- *Shërbim mirëmbajtje përditësim sistemi/analizimin e event log-eve*
- *Shërbim instalim programe software dhe drivera*
- *Shërbim profilaktik Laptop, Desktop*

*Sipas grupit të auditimit kërkesat e mësipërme për mirëmbajtje përbëjnë mbivendosje të shërbimeve dhe detyrave të specialisteve IT*

*Sipas Përshkrimeve të punës të Specialisteve IT ndër detyrave të tjera duhet të kryejnë:*

- a) Instalimin dhe mirëmbajtja e printerëve, skanerëve, fotokopjuesve, aparateve të faksit dhe pajisjeve të tjera elektronike.
- b) Diagnoza dhe riparimi i pajisjeve elektronike me defekt, me mbështetjen e furnitorëve nëse është e nevojshme.
- c) Sigurimi i mbështetjes së nivelit të parë për përdoruesit e brendshëm në lidhje me çështjet teknike edhe me ndihmën e softuerit Helpdesk.
- d) Zgjidhjen e problemeve teknike të përdoruesve, ose përndryshe dërgimin e rasteve të vështira në njësi të tjera të TI.
- e) Menaxhimi i licencave të softuerit.

*Sipas grupit të auditimit nga dokumentacioni i paraqitur, sa më sipër rreth 20 % e fondit limit të përlllogaritur ose 2,100,000 Lekë është investim pa efektivitet .*

-Në datën 03.12.2020 u mblodh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.70, datë 03.12.2020, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se në shtojcën 2.4 për kapacitetin teknik është kërkuar :

*Operatori ekonomik duhet të disponojë numrin mesatar prej jo më pak se 9 (nëntë) punonjës, për periudhën Maj-Tetor 2020, të vërtetuar me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.*

Kërkesa e kërkuar nga autoriteti kontraktor për 9 (nëntë) punonjës që të përmbushen nga operatori ekonomik, sipas grupit të auditimit konsiderohet një kërkesë e tepërt pasi autoriteti kontraktor nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, qëllimi i realizimit të këtij prokurimi mund të arrihet dhe me një numër më të ulet punonjësish. Kriteri nuk është në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 23,pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Referuar nenit 23 të ligjit të Prokurimit Publik, pika 3, përcaktohet se: “në përshkrimin e mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale”.

Në pikën 2.4.d) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata ISO të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), përkatësisht: .

-me Çertifikatën OHSAS 18001-2007 ose ekuivalente ISO 45001:2018), lidhur me

sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

-me Çertifikatën OHSAS 20000-1:2011 (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Sipas grupit të auditimit përcaktimet e kritereve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : *“Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 ‘Kërkesat e cilësisë’ të VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar në të cilin citohet se : “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit” dhe pikën 3 të Nenit 46 ‘Kualifikimi i ofertuesve’ të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.*

Lidhur me kriteret për kualifikim se Dokumenteteve të Tenderit nuk ka patur ankesa në AK Për këtë procedure prokurimi ka e dorëzuar ofertën ekonomike dhe dokumentacionin administrativo-ligjor operatori ekonomike si më poshtë:

1. "D" shpk, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar prej 1.284,300 (një milion dyqind e tetëdhjetekatër mijë e treqind) lekë pa TVSh.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kritereve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, të dokumentacionit administrativo-ligjor. rezultoi se OE "D" shpk, i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DT.

KVO ka vendosur ta pranojë ofertën e paraqitur nga OE si më poshtë:

1. "D" shpk, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar prej 1,284,300 (një milion dyqind e tetëdhjetekatër mijë treqind) lekë pa TVSh. Më pas, mbështetur në nenin 66, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

Për sa më sipër, KVO në përfundim të zhvillimit të procedurës dhe të afatit të ankimimit, si dhe mbështetur në nenin 68 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i propozon Titullarit të AK miratimin e procedurës me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT", dhe shpalljen si fitues të saj operatorin ekonomik "D" shpk, me shumatoren e çmimeve për njësi prej 1,284,300 lekë pa TVSh.

## ➤ **Procedura me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT" viti 2021**

Të dhëna të përgjithshme të procedurës

|                                                                       |                                                                                 |                                                                         |
|-----------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>Urdhër prokurimi</b> , nr 104, datw 06.12.2021                     | Hartuesit e specifikimeve Teknike dhe fondi limit<br>1. A.H<br>2. V.C<br>3. D.K | <b>Komisioni i Vlerësimit të ofertave</b><br>1. G.K<br>2. E.Q<br>3. D.K |
| Fondi Limit : 10,760,000 Lekë pa tvsh                                 |                                                                                 |                                                                         |
| <b>Procedura e prokurimit</b> – Procedurë e hapur -Marrëveshje kuadër |                                                                                 |                                                                         |
| <b>Datë e hapjes së tenderit</b> 24.01.2022                           | <b>Njesia e Prokurimit</b><br>4. E.T<br>5. B.ZH<br>6. S.L                       | Grupi ngarkuar për zbatimin e kontratës<br>4. R.H<br>5. D.K<br>6. K.D   |

|                                                                           |                                                                    |                                                      |
|---------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
|                                                                           |                                                                    |                                                      |
| Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>2. "A" shpk<br>3. "D" shpk | <b>Operatore te Kualifikuar:</b><br>1. "D" shpk                    | <b>Operatorë të s kualifikuar</b><br>"A" shpk        |
| <b>Ankimime në AK për vleresim- jo</b>                                    | <b>Diferenca nga fondi limit.</b><br>381,758                       | <b>Vlera e kontratës</b><br>1,385,260 Lekë për njësi |
|                                                                           | <b>Afati kontratës</b> 60 dite nga data e nënshkrimit të kontratës | <b>Operatori Fitues:</b><br>."D"" shpk               |

Në bazë të urdhrit nr.104, datë 06.12.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT" më datë 06.12.2021 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit.

Në datën 20.12.2021 u mbledh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.118, datë 20.12.2021, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës nder të tjera janë kërkuar

- *Shërbim mirëmbajtje dhe kontroll periodik (pastrim nga viruset)*
- *Shërbim update antivirusi dhe sistemi operativ*
- *Shërbim Instalim/konfigurim/update firmware*
- *Shërbim update firmware*
- *Shërbim mirëmbajtje sistemi operativ për ekranin ndërveprues*
- *Shërbim mirëmbajtje përditësim sistemi/analizimin e event log-eve*
- *Shërbim instalim programe software dhe drivera*

*Sipas grupit të auditimit kërkesat e mësipërme për mirëmbajtje përbëjnë mbivendosje të shërbimeve dhe detyrave të specialisteve IT*

*Sipas Përshkrimeve të punës të Specialisteve IT ndër detyrave të tjera duhet të kryejnë:*

- f) Instalimin dhe mirëmbajtja e printerëve, skanerëve, fotokopjuesve, aparateve të faksit dhe pajisjeve të tjera elektronike.
- g) Diagnoza dhe riparimi i pajisjeve elektronike me defekt, me mbështetjen e furnitorëve nëse është e nevojshme.
- h) Sigurimi i mbështetjes së nivelit të parë për përdoruesit e brendshëm në lidhje me çështjet teknike edhe me ndihmën e softuerit Helpdesk.
- i) Zgjidhjen e problemeve teknike të përdoruesve, ose përndryshe dërgimin e rasteve të vështira në njësi të tjera të TI.
- j) Menaxhimi i licencave të softuerit.

*Sipas grupit të auditimit nga dokumentacioni i paraqitur, sa më sipër rreth 20 % e fondit limit të përlllogaritur ose 2,100,000 Lekë është investim pa efektivitet .*

Lidhur me kriteret për kualifikim të Dokumenteve të Tenderit pranë AK nuk është paraqitur asnjë ankesë nga operatorët ekonomikë.

Sipas Kriterëve të veçanta Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata ISO të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), përkatësisht:

- b. ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë;

- c. OHSAS 20000-1:2011 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit;
- d. ISO/IEC 27001:2013 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 9 (nëntë)** persona

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit kryesorë të kualifikuar të mëposhtëm:

- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet operative Windows 7/10 ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje printimi OKI/Lexmark/HP/Toshiba ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet operative Windows Server ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për rrjetat kompjuterike ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje fuqie të vogla Ups Mercury/Infosec/Power Tree ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje fuqie Ups;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje rrjeti Cisco/Juniper/HP ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje Audio konferenca/perkthimi Temas/Gesston/AltoProfessional/ ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje Vizuale te tipit panele profesionale ose videowall: Samsung/Vestel/Panasonic ose ekuivalent;

1 (një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimin e shërbimeve, objekt i këtij prokurimi

Nga auditimi konstatohet se kriteret :

- OHSAS 20000-1:2011 ose ekuivalente
- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 9 (nëntë)** persona
- 1 (një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimin e shërbimeve, objekt i këtij prokurimi

Sipas grupit të auditimit përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : *“Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 ‘Kërkesat e cilësisë’ të VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar në të cilin citohet se : “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit” dhe pikën 3 të Nenit 46 ‘Kualifikimi i ofertuesve’ të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.*

Për këtë procedurë paraqiten interes dhe dorëzuan ofertat në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së operatorët ekonomikë, si më poshtë:

1. OE "D" shpk, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar prej 1,385.260 lekë pa TVSh;
2. OE "A" shpk, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar prej 1,399,870 lekë pa TVSh.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, te dokumentacionit administrativo-ligjor dhe financiar të 2 ofertave të paraqitura për këtë procedure rezulton si më poshtë:

1. OE D" shpk i plotëson të gjitha kriteret e DT.
2. OE "A" shpk nuk i plotëson të gjitha kriteret e DT, për arsye si më poshtë:

Nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pikën 2.3.3, pasi në Formularin e vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, nuk ka paraqitur që disponon punonjës me certifikimet si më poshtë:

1 (një) specialist i certifikuar për pajisje printimi OKI/Lexmark/HP/Toshiba ose ekuivalent;  
1 (një) specialist i certifikuar për pajisje fuqie të vogla Ups Mercury/Infosec/Power Tree ose ekuivalent; 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje fuqie UPS;  
Temas/Gesston/AltoProfessional ose ekuivalent; 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje Vizuale të tipit panele profesionale ose videocall: Samsung/Vestel/Panasonic ose ekuivalent.  
Në përfundim të gjithë procesit të vlerësimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, KVO rendit ofertat e vlerësuara të vlefshme, si më poshtë:

1. OE "D" shpk, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar prej 1,385,260 lekë

Në datën 14.02.2021 është bërë njoftimi paraprak i OE fitues "D" shpk

KVO në përfundim të zhvillimit të procedurës dhe të afatit të ankimimit, si dhe mbështetur në nenin 84 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i dërgon Titullarit të AK miratimin e procedurës me objekt "Mirëmbajtje e zakonisht pajisjesh elektronike për UT", dhe shpalljen si fitues të saj operatorin ekonomik "D" shpk, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar prej 1,385,260 (një milion e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSh.

#### ➤ **Procedura e prokurimit publik me objekt “Blerje pajisje për laborator përkthimi dhe interpretimi në FGJH”**

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

|                                                              |                                                                                   |                                                               |
|--------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|
| 1. Urdhër Prokurimi: Nr. 57 Prot., datë 01.10.2021           | 3. Hartuesit e specifikimeve teknike:<br>E.T<br>D.K<br>M.P                        | 4. Komisioni i llogaritjes së fondit limit:<br>ET<br>DK<br>MP |
| 2. Fondi Limit (pa tvsh)<br>14.720.000 lekë:                 |                                                                                   |                                                               |
| 5. Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“Procedurë e hapur”  | 6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit:<br>ET<br>DK<br>MP                            | 7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:<br>EQ<br>AH<br>AS         |
| 8. Data e hapjes së tenderit: 25.10.2021                     | 9. Operatori fitues: “P”<br>Vlera e ofertës fituese, pa TVSH,<br>14.560.000 lekë: | 10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 160.000 lekë          |
| 11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>4 (katër) | 12. Operatore të Kualifikuara:<br>1 (një)                                         | 13. Operatorë të skualifikuar:<br>3 (tre)                     |
| 14. Ankimimet:<br>Nuk ka                                     | 15. Përgjigje Ankesës nga AK<br>Nuk ka                                            | 16. Përgjigje Ankesës nga KPP:<br>Nuk ka                      |
| 17. Marrja në Dorëzim<br>Datë 28.01.2022                     | 18. Vlera e kontratës (me tvsh):<br>17.472.000 lekë                               | 19. Afati i kontratës: 60 Ditë                                |

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:** Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në për llogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e

punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:** Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

- Operatori ekonomik: “F” shpk nuk i ka plotësuar kriteret e DT për shkak se nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar nga AK. Referuar nenit 92, pika 3 të LPP, KVO e ka refuzuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “R” shpk nuk i ka plotësuar kriteret e DT për shkak se nuk ka paraqitur dokumentacionin si në vijim: Formularin e sigurimit të ofertës, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, formularin e ofertës dhe të çmimit, vërtetimin për xhiron vjetore. Ky OE nuk ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, ku referuar nenit 92, pika 3 të LPP, KVO e ka refuzuar ofertën.

- Operatori ekonomik: “P” i ka plotësuar kriteret e DT, në këto kushte KVO e ka kualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “A” nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e DT për shkak se nuk ka dorëzuar dokumentacionin e plotë të kërkuar nga AK. Ky OE nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare etj. Për sa më sipër KVO e ka refuzuar kërkesën e këtij OE.

**-Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:**

- Me Urdhrin nr. 58/1 datë 2.12.2021 të Administratorit është ngritur komisioni për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të përbërë nga BZH, EH dhe VF.

- Më datë 28.01.2022 në Rektoratin e UT është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim.

**Zhvillimi i kontratës:**

- Në bazë të urdhrin nr. 48, datë 27.09.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit” të kontratës me objekt “Blerje pajisje për laborator përkthimi dhe interpretimi në FGJH” më datë 01.10.2021 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit. Më 06.10.2021 Njësia e Prokurimit e përbërë nga ET, AH dhe AS, është mbledhur në zbatim të UP të Titullarit nr. 57, datë 01.10.2021, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

- Njoftimi i kontratës dhe dokumentet e këtij tenderi u publikuan në faqen zyrtare të APP-së në datën 07.10.2021, ndërsa njoftimi i kontratës u shpall në buletin e njoftimeve publike në datën 11.10.2021.

- Për këtë procedurë paraqitën interes dhe dorëzuan ofertat në sistemin elektronik të APP-së operatorët, si më poshtë:

1. OE “FE” shpk, ka paraqitur ofertën me vlerë 0 lekë pa TVSH;
2. OE “R” shpk, ka paraqitur ofertën me vlerë 14,560,000 lekë pa TVSH;
3. OE “P” shpk, ka paraqitur ofertën me vlerë 14,560,000 lekë pa TVSH;
4. OE “AC” shpk, ka paraqitur ofertën me vlerë 14,620,000 lekë pa TVSH.

Në datën 03.11.2021 është bërë njoftimi paraprak i OE fitues “P” shpk, njoftimi i formularit u shpall në buletin e njoftimeve publike në datën 08.11.2021. Lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave brenda afatit ligjor ankimor, nuk ka patur ankesa pranë AK Rektoratit të UT-së, nga operatorët ekonomikë.

KVO në përfundim të zhvillimit të procedurës dhe të afatit të ankimit, si dhe mbështetur në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ka dërguar Titullarit të AK miratimin e procedurës me objekt “Blerje pajisje për laborator përkthimi dhe interpretimi në FGJH” dhe shpalljen si fitues të saj OE “P” shpk, me vlerë 14,560,000 lekë pa TVSH, me vendim nr. 2514/5 Prot. datë 15.11.2021.

- Më datë 01.12.2021 është lidhur kontrata me nr. 2514/7 Prot. ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe OE "P" shpk me objekt "Blerje pajisje për laborator përkthimi dhe interpretimi në FGJH" me vlerë 14.560.000 Lekë pa TVSH dhe 17.472.000 Lekë me TVSH, me afat ekzekutimi 60 ditë deri më 05.02.2022.

- Afati për shlyerjen e pagesës në bazë të kontratës ndërmjet palëve është 30 ditë nga afati maksimal i lëshimit të faturës tatimore. Fatura është lëshuar nga OE më datë 28.01.2022 dhe likuidimi është kryer me urdhër shpenzimi nr. 81, më 23.03.2022, jashtë afatit të përcaktuar.

➤ **Zhvillimi i procedurës me objekt "Blerje pajisje për laboratorë didaktikë në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës në shërbim të fuqizimit të kërkuesve të rinj dhe të studentëve në FGJH"**

|                                                                           |                                                                    |                                                                         |
|---------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>Urdhër prokurimi,</b> nr 87, datë 12.11.2021                           | Hartuesit e specifikimeve Teknike dhe fondi limit                  | <b>Komisioni i Vlerësimit të ofertave</b>                               |
| Fondi Limit : 20,252,858                                                  | 4. OK<br>5. ET<br>6. M P                                           | 4. EQ<br>5. AH<br>6. AS                                                 |
| <b>Procedura e prokurimit</b> – Procedurë e hapur                         |                                                                    |                                                                         |
| <b>Datë e hapjes së tenderit</b> 16.12.2021                               | <b>Njësia e Prokurimit</b><br>7. ET<br>8. DK<br>9. SL              | Persona e ngarkuar për zbatimin e kontratës<br>7. BZH<br>8. EH<br>9. VF |
| Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>4. "P" shpk<br>5. "S" shpk | <b>Operatore të Kualifikuar:</b><br>6. "P" shpk<br>7. "S" shpk     | <b>Operatorë të s kualifikuar</b><br>ska                                |
| <b>Ankimime në AK për vlerësim- jo</b>                                    | <b>Diferenca nga fondi limit.</b><br>381,758                       | <b>Vlera e kontratës</b><br>19,871,100                                  |
|                                                                           | <b>Afati kontratës</b> 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës | <b>Operatori Fitues:</b><br>."P" shpk                                   |

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se nuk ka një kërkesë të nevojës së AK për kryerjen e këtij shpenzimi dhe mbi arsyet e domosdoshmërisë së këtij prokurimi, si dhe nuk ka të bashkëlidhur argumentimin përkatës në të cilin është parashikuar kryerja e këtij shpenzimi.

Në bazë të urdhrit nr.87, datë 12.11.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt "Blerje pajisje për laborator përkthimi dhe interpretimi në FGJH" më datë 24.11.2021 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit.

Në datën 26.11.2021 u mblodh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.99, datë 24.11.2021, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Njoftimi i Kontratës dhe dokumentet e këtij tenderi u publikuan në faqen e SPE të APP-së në datën 01.12.2021, ndërsa në buletin zyrtar të njoftimeve publike u shpall në datën 06.12.2021. Për këtë procedurë dhe dorëzuan ofertat në sistemin elektronik të APP-së operatorët ekonomikë, si më poshtë:

1. OE "P" shpk, me vlerë të ofertës prej 19,871,100 lekë pa TVSh; 2. OE "S" shpk, me vlerë të ofertës prej 20,150,700 lekë pa TVSh.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, të dokumentacionit administrativo-ligjor dhe financiar, të 2 ofertave të paraqitura për këtë procedurë rezulton si më poshtë:

1. "P" shpk plotëson të gjitha kriteret e DT.
2. "S" shpk plotëson të gjitha kriteret e DT.

Në përfundim të gjithë procesit të vlerësimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, KVO rendit ofertat e vlerësuara të vlefshme, si më poshtë:

1. OE "P" shpk, me vlerë të ofertës prej 19,871,100 lekë pa TVSh;
2. OE "S" shpk, me vlerë të ofertës prej 20,150,700 lekë pa TVSh.

Në datën 24.12.2021 është bërë publikimi i njoftimit paraparak i OE fitues "P" shpk, ndërsa në buletin e njoftimeve publike u shpall në datën 28.12.2021.

Lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave brenda afatit ligjor ankimor nuk ka patur ankesë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, rrjedhimisht, nëpërmjet një kërkesë në SPE, KVO do ti kërkojë OE i renditur i pari, të paraqesë brenda 5 ditëve dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentat e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

Për sa më sipër, KVO në përfundim të zhvillimit të procedurës dhe të afatit të ankimit, si dhe mbështetur në nenin 84 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i dërgon Titullarit të AK miratimin e procedurës me objekt "Blerje pajisje për laboratore didaktikë në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës në shërbim të fuqizimit të kërkuesve të rinj dhe të studentëve në FGJH", dhe shpalljen si fitues të saj operatorin ekonomik "P" shpk, me vlerë 19,871,100 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e njëqind) lekë pa TVSh.

### **Marrja në dorëzim**

- Është lidhur kontrata me nr.3077/7 më datë 18.01.2022 me Operatorin Ekonomik "P" shpk me vlerë 19,871,100 pa Tvsh me afat ekzekutimi 60 ditë, deri më 16.03.2022.
- Me urdhrin 100/1 datë 18.01.2022 të administratorit ngrihet komisioni për zbatimin e kontratës të përbërë nga BZH, EH, VF
- Pagesa e mallrave sipas kontratës duhet të bëhet Brenda 30 ditëve nga dita që dokumentacioni vërteton përmbushjen e kushteve të kontratës. Fatura është lëshuar nga OE më datë 16.03.2022 dhe likuidimi është bërë më datë 06.06.2022, jashtë afatit të përcaktuar në kontratë Pagesa është kryer jashtë afatit të parashikuar në kontratë.

**2.Titulli i Gjetjes:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit TIK rezulton se në të paktën 4 procedura janë kërkuar kriterë të veçanta kualifikimi jo në përputhje me objektin e prokurimit, konkretisht :

- 1) *Procedura Blerje pajisje Elektronike, softe për përpunimin e të dhënave cilësore programe software, aplikacion për studentët, , sistem kamerash*
- 2) *"Blerje pajisje elektronike dhe audiovizuale për UT*
- 3) *"Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2020.*
- 4) *Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2021*

**Situata 1 :**

**Procedura e prokurimit “Blerje pajisje Elektronike, softë për përpunimin e të dhënave cilësore programe software, aplikacion për studentët, sistem njoftimi, sistem kamerash”, i ndarë në 2 lote ,viti 2020.**

Në datën 09.12.2020 u mbledh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.76, datë 09.12.2020, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik. Kriteret e veçanta të kualifikimit ,pika 2.4 :

- 1 (një) specialist të certifikuar për softë Desktop Gis ose ekuivalent; Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa për operatorët ekonomikë për të patur Specialist të certifikuar për softë Desktop Gis është e pa nevojshme, pasi nga AK është kërkuar instalimi i Licensave GIS në softë Gis ,veprim të cilin çdo specialisti mund ta kryejë pa patur nevojën e certifikimit Gis.

1 (një) specialist të certifikuar për sistemin e menaxhimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet në nivel CCNP ose ekuivalent;

Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa për operatorët ekonomikë për të patur një specialist të certifikuar me Cisco Certified Network Professional (CCNP) në një procedurë furnizim me mallra ku pajisjet e rrjetit janë Switch ,firewall është e panevojshme pasi instalimi i këtyre pajisjeve mund të kryet dhe nga 1 specialist me eksperiencë të certifikuar në pajisje rrjeti në nivel më të ulët.

Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : *“Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 ‘Kërkesat e cilësisë’ të VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar në të cilin citohet se : “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit” dhe pikën 3 të Nenit 46 ‘Kualifikimi i ofertuesve’ të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.”*

**Situata 2 :**

**Procedura e prokurimit: “Blerje pajisje elektronike dhe audiovizuale për UT”.**

Në datën 19.11.2021 u mbledh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.85, datë 10.11.2021, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik. Njoftimi i Kontratës dhe dokumentet e këtij tenderi u publikuan në faqen e SPE të APP-së në datën 22.11.2021, ndërsa në buletin zyrtar të njoftimeve publike u shpall në datën 01.12.2021.

Lidhur me kriteret për kualifikim të Dokumenteve të Tenderit nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Me urdhrin e Titullarit të AK-së nr.86/1, datë 02.12.2021 është pezulluar procedura e prokurimit me iniciativën e Njesisë së prokurimit, e cila ka modifikuar DT nëpërmjet shtojcës nr.1, datë 02.12.2021.

Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit - Kapaciteti ekonomik dhe financiar - pika 2.2.1 nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se kriteri i vendosur për 1 (një) specialist i çertifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimin e shërbimeve të suportit dhe garancisë, objekt i këtij prokurimi është e panevojshme pasi procedura e kërkuar është për blerje pajisje elektronike dhe jo për implementim projekti. Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : “Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 ‘Kërkesat e cilësisë’ të VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar në të cilin citohet se : “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”

**Situata 3 : *Procedura me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT" viti 2020.***

-Në datën 03.12.2020 Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.70, datë 03.12.2020, hartoi kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit konstaton se në shtojcën 2.4 për kapacitetin teknik është kërkuar :

*Operatori ekonomik duhet të disponojë numrin mesatar prej jo më pak se 9 (nëntë) punonjës, për periudhën Maj-Tetor 2020, të vërtetuar me vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.*

Kërkesa e kërkuar nga autoriteti kontraktor për 9 (nëntë) punonjës që të përmbushen nga operatori ekonomik, sipas grupit të auditimit konsiderohet një kërkesë e tepërt pasi autoriteti kontraktor nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, qëllimi i realizimit të këtij prokurimi mund të arrihet dhe me një numër më të ulët punonjësish. Kriteri nuk është në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 23,pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Referuar nenit 23 të ligjit të Prokurimit Publik, pika 3, përcaktohet se: “në përshkrimin e mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale”.

Në pikën 2.4.d) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata ISO të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), përkatësisht:

- me Çertifikatën OHSAS 18001-2007 ose ekuivalente ISO 45001:2018), lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- me Çertifikatën OHSAS 20000-1:2011 (ose ekuivalente), lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Sipas grupit të auditimit përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : *“Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 ‘Kërkesat e cilësisë’ të VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar në të cilin citohet se : “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit” dhe pikën 3 të Nenit 46 ‘Kualifikimi i ofertuesve’ të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.*

**Situata 4 : Procedura me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT" viti 2021**

Në datën 20.12.2021 Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.118, datë 20.12.2021, hartoi dhe miratoi kriteret të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Sipas Kriterëve të veçanta Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata ISO të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA), përkatësisht:

- e. ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- f. OHSAS 20000-1:2011 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit;
- g. ISO/IEC 27001:2013 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 9 (nëntë)** persona

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit kryesorë të kualifikuar të mëposhtëm:

- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet operative Windows 7/10 ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje printimi OKI/Lexmark/HP/Toshiba ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet operative Windows Server ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për rrjetat kompjuterike ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje fuqie të vogla Ups Mercury/Infosec/Power Tree ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje fuqie Ups;
- 1 (një) specialist i certifikuar për pajisje rrjeti Cisco/Juniper/HP ose ekuivalent;

- 1 (një) specialist i çertifikuar për pajisje Audio konferenca/perkthimi Temas/ Gesston/AltoProfessional/ ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i çertifikuar për pajisje Vizuale te tipit panele profesionale ose videowall: Samsung/Vestel/Panasonic ose ekuivalent;
- 1 (një) specialist i çertifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qellim menaxhimin e shërbimeve, objekt i këtij prokurimi

Nga auditimi konstatohet se kriteret :

- OHSAS 20000-1:2011 ose ekuivalente
- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 9 (nëntë) persona**
- 1 (një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qellim menaxhimin e shërbimeve, objekt i këtij prokurimi

Sipas grupit të auditimit përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : *“Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 ‘Kërkesat e cilësisë’ të VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar në të cilin citohet se : “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit” dhe pikën 3 të Nenit 46 ‘Kualifikimi i ofertuesve’ të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilin citohet se : “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.*

|                        |                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kriteri:</b>        | Neni 2, Neni 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik VKM 285, Datë 19.05.2021 ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, ndryshuar                                                                                                      |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b> | Shmangia e konkurrencës në procedurat e prokurimit.                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>Shkaku:</b>         | Mosrespektim i akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit Publik për të hartimit të kriterëve të kualifikimit.                                                                                                                                                         |
| <b>Rëndësia</b>        | E lartë                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Rekomandim:</b>     | Titullri i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që nga ana e grupeve të punës që do të ngrihen për hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të mos hartohen kriterë që janë jashtë objektit të prokurimit. |

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me shkresën nr. 1522/5 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/12, datë 07.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 468/15, datë 05.12.2022.

### **1.Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me konstatimin e audituesve për objektin **me REF-81510-12-09-2020, Loti 1: F.V.Blerje pajisje elektronike, softje për përpunimin e të dhënave cilësore, programe software, aplikacion për studentët, sisteme njoftimi etj**" Gjykojmë se është e domosdoshme që operatorët ekonomike të disponojnë një staf tekniko profesional të kualifikuar me diplomat apo certifikatat e cilësuar më sipër në fushën e objektit që prokurohet, që do të angazhohen për të përmbushur me sukses dhe në kohë kontratën, bazuar në preventivin, sasitë dhe specifikimet teknike të pajisjeve që nevojiten për të instaluar, konfiguruar dhe që do të mbikëqyrin të gjithë procesin nga porositja, magazinimi, transportimi deri te instalimi i pajisjeve. Kështu, kërkesa për 1 (një) specialist i certifikuar për softvvarin Desktop Gis ose ekuivalent, është e domosdoshme pasi AK ka kërkuar pajisje të tipit (F.V. Licensa Program GIS), që kërkojnë njohuri përkatëse për instalimin dhe trajnimin e personelit që do të përdorë këtë licensë, referuar specifikimeve teknike (Analizim dhe vizualizim të dhënash). Gjithashtu, kërkesa për 1 (një) specialist të certifikuar për sistemin e menaxhimit të politikave të sigurisë dhe aksesit në rrjet në nivel CCNP ose ekuivalent, është e domosdoshme pasi AK ka kërkuar pajisje të tipit (F.V. swich, firewall, etj.) që kërkojnë njohuri përkatëse të vërtetuar nga një organ certifikues të kësaj natyre, për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve në rrjete kompjuterike, dhe sipas protokolleve të sigurisë që duhet të ketë palisja firevball Që do të ofrohet nën OE. Kjo pajisje është një pajisje qendrore e cila do të instalohet dhe konfigurohet në Rektorat.

Në lidhje me konstatimin e audituesve për objektin **me REF-12270-11-19-2021, Loti 1: Blerje pajisje elektronike**" se: "...Njësia e Prokurimit nuk i ka hartuar kriteret në përputhje me pikën c të nenit 2 dhe pikën 3 të nenit 46, të LPP, si dhe pikën 3, të nenit 44, të përkatësisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.3, kërkesën për:

1 (një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimit e shërbimeve të suportit dhe garancisë, objekt i këtij prokurimi. është e panevojshme pasi procedura e kërkuar është për blerje pajisje elektronike dhe jo për implementim projekti", sqarojmë se,

Vendosja e këtij kriteri është bërë në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5, germa b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Gjykojmë se është e domosdoshme kërkesa për 1 (një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimit e shërbimeve të suportit dhe garancisë, objekt i këtij prokurimi, në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës, kohëzgjatjes të saj (deri në 3 vit për garancitë e suporteve) dhe rëndësisë operationale që kanë sistemet ekzistuese të AK, ku të gjitha këto duhet domosdoshmërisht të ndiqen nga një profesionist kualifikuar në menaxhimit e projekteve të zbatimit nga fillimi (nënshkrimi i kontratës) deri në përfundim të saj, në mënyrë që të minimizohet në maksimum risku i mosrealizimit të kontratës për arsye menaxheriale.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa për operatorët ekonomikë për të patur Specialist të certifikuar për softuerin Desktop Gis është e pa nevojshme, pasi nga AK është kërkuar instalimi i Licensave GIS në software Gis ,veprim të cilin çdo specialisti mund ta kryejë pa patur nevojën e certifikimit Gis.

Në opinionin e grupit të auditimit kërkesa për operatorët ekonomikë për të patur një specialist të certifikuar me Cisco Certified Network Professional (CCNP) në një procedurë furnizim me mallra ku pajisjet e rrjetit janë Switch ,firewall është është e panevojshme pasi instalimi i këtyre pajisjeve mund të kryet dhe nga 1 specialist me eksperiencë të certifikuar në pajisje rrjeti në nivel më të ulët.

Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se : "Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 'Kërkesat e cilësisë' të VKM 285, Datë 19.05.2021 'Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', ndryshuar në të cilin citohet se : "Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit" dhe pikën 3 të Nenit 46 'Kualifikimi i ofertuesve' të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se : "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik."

Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit - Kapaciteti ekonomik dhe financiar - pika 2.2.1 nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se kriteri i vendosur për 1 (një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimin e shërbimeve të suportit dhe garancisë, objekt i këtij prokurimi. është e panevojshme pasi procedura e kërkuar është për blerje pajisje elektronike dhe jo për implementim projekti.

Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se : "Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik.

Grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me shkresën nr. 1522/5 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/12, datë 07.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 468/15, datë 05.12.2022.

## **2.Pretendimi i Subjektit:**

Në lidhje me konstatimin e audituesve për objektet "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjeshelektronike për UT" me REF-80882-12-03-2020, si dhe REF-16661-12-29-2021, Numri prej 9(nëntë) punonjësish lidhet edhe me kërkesën për kriterin në vazhdim, pikën 2.3.3 të KVK të DST, ku OE duhet të disponojë punonjësit kryesorë të kualifikuar dhe të certifikuar -(një) specialist i certifikuar për ITIL ose ekuivalent, me qëllim menaxhimin e shërbimeve, objekt i këtij prokurimi. Pasi, nga specifikimet teknike dhe termat e reference, vëmë re, se kemi shumë kategori pajisjesh me natyrë teknike të ndryshme (Kompjuter Desktop, Pajisje Laptop, Printera, Fotokopje, Ups — Inverter, Projektore, Pajisje Network, Pajisje Vizuale, Pajisje Audio, Pajisje Servera) të cilat kanë nevojë për specialist të certifikuar që t'u përgjigjen difekteve të tyre .Gjithashtu, ju vëmë në dijeni, se lidhur me kriteret për kualifikimin të dokumenteve të Në lidhje me konstatimin e audituesve për objektet

"Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT" me REF-80882-12-03-2020, si dhe REF-16661-12-29-2021, se: "...Njësi e Prokurimit nuk i ka hartuar kriteret në përputhje me pikën c të nenit 2, si dhe pikën 3, të nenit 44, të VKM, përkatësisht në kriteret e veçanta të kualifikimit, pikën 2.4.1, kërkesën për:

OHSAS 18001:2007 ose ekuivalente ISO 45001:2018, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;

OHSAS 20000-1:2011 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit; ", sqarojmë se,

Vendosja e këtyre kriterëve është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike" të ndryshuar, neni 46, pika 2 ku citohet:

2. AK mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

si dhe. në VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 30 "Kërkesat e cilësisë", pika 1, ku citohet:

Disponimi i 18001-2007 ose ekuivalente ISO 45001:2018, lidhet me kërkesat për menaxhirnin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, për çdo punonjës. Ky standard krijon kushte më të mira të punës, identifikon kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin pasojave që vijnë nga dëmtimet, redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot, përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune.

Disponimi i OHSAS 20000-1:2011 ose ekuivalente, lidhet me sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit. Standard i cili përmirëson komunikimin ndërmjet organizatave OE dhe AK, krijon siguri dhe ofrimin e shërbimeve që të përmbushen nevojat e punës dhe të jenë efikase në përdorim e burimeve menaxheriale.

Pra, këto standarde mundësojnë menaxhimin e cilësisë, sigurisë në punë, menaxhimin dhe vlerësimin e konformitetit duke siguruar kështu që shërbimet dhe materialet zëvendësuese - ië jenë të sigurta, të besueshme dhe të cilësisë së mirë, të ofrojnë standarde në kryerjen e shërbimeve në respektim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e informacionit, teknikat dhe metodat që përdorin.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Sipas grupit të auditimit përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën c të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se : "Qëllimi i këtij ligji është: ... c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, Pikën 3 të Nenit 44 'Kërkesat e cilësisë' të VKM 285, Datë 19.05.2021 'Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', ndryshuar në të cilin citohet se : "Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit" dhe pikën 3 të Nenit 46 'Kualifikimi i ofertuesve' të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

- zj.ET anëtare e njësisë së prokurimit
- zj.DK anëtare e njësisë së prokurimit
- z.SL anëtar i njësisë së prokurimit
- j.MP anëtare e njësisë së prokurimit

**3.Titulli i Gjetjes:** Nga auditimi i procedurave :“**Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2020” dhe Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2021**” u konstatua se shërbimet e kërkuara në specifikimet teknike janë të mbivendosura me shërbimet dhe detyrat e specialistëve IT.

**Situata 1:**

Në bazë të urdhrit nr.67, datë 27.11.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT", më datë 02.12.2020 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit. Sipas specifikimeve Teknike ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Shumatorja e çmimeve për njësi të OE, nuk duhet të kalojë shumatoren e çmimeve për njësi të publikuar në DT, në të kundërt oferta do të refuzohet; Vlera e pritshme e kontratave nuk duhet të kalojë fondin limit të MK (vlerën e pritshme të kontratave) të publikuar në DT.

Në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës nder të tjera janë kërkuar

- *Shërbim mirëmbajtje dhe kontroll periodik (pastrim nga viruset)*
- *Shërbim update antivirusi dhe sistemi operativ*
- *Shërbim Instalim/konfigurim/update firmware*
- *Shërbim update firmware*
- *Shërbim mirëmbajtje sistemi operativ për ekranin ndërveprues*
- *Shërbim mirëmbajtje përditësim sistemi/analizimin e event log-eve*
- *Shërbim instalim programe software dhe drivera*
- *Shërbim profilaktik Laptop, Desktop*

1s *grupit të auditimit kërkesat e mësipërme për mirëmbajtje përbëjnë mbivendosje të shërbimeve dhe detyrave të specialisteve IT*

1s *Përshkrimeve të punës të Specialisteve IT ndër detyrave të tjera duhet të kryejnë:*

k) Instalimin dhe mirëmbajtja e printerëve, skanerëve, fotokopjuesve, aparateve të faksit dhe pajisjeve të tjera elektronike.

l) Diagnoza dhe riparimi i pajisjeve elektronike me defekt, me mbështetjen e furnitorëve nëse është e nevojshme.

m) Sigurimi i mbështetjes së nivelit të parë për përdoruesit e brendshëm në lidhje me çështjet teknike edhe me ndihmën e softuerit Helpdesk.

n) Zgjidhjen e problemeve teknike të përdoruesve, ose përndryshe dërgimin e rasteve të vështira në njësi të tjera të TI.

o) Menaxhimi i licencave të softuerit.

Sipas grupit të auditimit nga dokumentacioni i paraqitur, sa më sipër rreth 16.2 % e fondit limit prej 10,759,400 Lekë të përlllogaritur ose 1,746,300 Lekë pa Tvsh është investim pa efektivitet.

**Situata 2 :**

Në bazë të urdhrit nr.104, datë 06.12.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objekt "Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT" më datë 06.12.2021 janë hartuar specifikimet teknike dhe fondi limit.

Në datën 20.12.2021 u mblodh Njësia e Prokurimit, në zbatim të UP të Titullarit nr.118, datë 20.12.2021, për hartimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit për këtë objekt prokurimi publik.

Në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës nder të tjera janë kërkuar

- *Shërbim mirëmbajtje dhe kontroll periodik (pastrim nga viruset)*

- Shërbim update antivirusi dhe sistemi operativ
- Shërbim Instalim/konfigurim/update firmware
- Shërbim update firmware
- Shërbim mirëmbajtje sistemi operativ për ekranin ndërveprues
- Shërbim mirëmbajtje përditësim sistemi/analizimin e event log-eve
- Shërbim instalim programe software dhe drivera

Sipas grupit të auditimit kërkesat e mësipërme për mirëmbajtje përbëjnë mbivendosje të shërbimeve dhe detyrave të specialisteve IT

Sipas Përshkrimeve të punës të Specialisteve IT ndër detyrave të tjera duhet të kryejnë:

- a) Instalimin dhe mirëmbajtja e printerëve, skanerëve, fotokopjuesve, aparateve të faksit dhe pajisjeve të tjera elektronike.
- b) Diagnoza dhe riparimi i pajisjeve elektronike me defekt, me mbështetjen e furnitorëve nëse është e nevojshme.
- c) Sigurimi i mbështetjes së nivelit të parë për përdoruesit e brendshëm në lidhje me çështjet teknike edhe me ndihmën e softuerit Helpdesk.
- d) Zgjidhjen e problemeve teknike të përdoruesve, ose përndryshe dërgimin e rasteve të vështira në njësi të tjera të TI.
- e) Menaxhimi i licencave të softuerit.

Sipas grupit të auditimit nga dokumentacioni i paraqitur, sa më sipër rreth 16.2 % e fondit limit prej 10,759,400 Lekë të përlllogaritur ose 1,746,300 Lekë pa Tvsh është investim pa efektivitet.

|                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
|------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kriteri:</b>        | Për sa më sipër, është në kundërshtim me detyrat e njësisë së IT në përshkrimet e punës.                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>Ndikimi/Efekti:</b> | Përdorim i shumës prej 3,492,600 Lekë pa TVSH nga fondet e Universitetit pa efektivitet                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Shkaku:</b>         | Mos analizim i saktë i nevojave dhe kërkesave të Universitetit në lidhje me investime në drejtim të shërbimeve IT. Mosnjohje dhe mos vlerësim i duhur i legjislacionit të prokurimit publik.                                                                                                               |
| <b>Rëndësia:</b>       | E Lartë                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Rekomandim:</b>     | Titullari i autoriteti kontraktor, të marrë masa në vijimësi në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë hartimin e fondit limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, për të shmangur përdorimin pa efektivitet të fondeve në të ardhmen. |

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me shkresën nr. 1522/5 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/12, datë 07.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 468/15, datë 05.12.2022.*

***Pretendimi i subjektit :***

*Në lidhje me konstatimin e audituesve observojmë për periudhën e auditimit për vitin 2020 dhe 2021, UT është gjendur para faktit të mungesës me personel të IT, si dhe me ndryshimet të strukturës së organizimit të miratuara për vitin 2020, e cila është një nga faktorët në mungesë të strukturave të IT. Për sa i përket shërbimeve profilaktike stafi i brendshëm i UT*

*nuk është e mundur ta bëjnë këtë proces teknikisht dhe praktikisht, në pajisje printera, fotokopje, laptop, desktop, etj, pasi nevojiten njohuri teknike dhe pajisje teknike të veçanta që shërbejnë për këtë qëllim, duke përdorur pajisje thithëse më vakum etj., të cilat UT nuk i disponon as si pajisje as si njohuri nga stafi i IT. Në lidhje me aspektet e sigurisë për sa u përket ernërtimeve update/upgrade antivirus sistemi operativ, etj., theksojmë se mirëmbajtja e këtyre sistemeve është nëse e domosdoshme në rastet e sulmeve të jashtme mbi çështjet e sigurisë së informacionit të UT. Duke qenë se stafi jonë është i kufizuar në numër dhe në njohuri, përgjatë viteve ka lindur nevoja që edhe këtë proces ta kryejnë OE me stafin e tyre specialist të çertifikuar për këto shërbime.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit :**

*Grupi i auditimit sqaron se kërkesat e mësipërme për mirëmbajtje të pajisjeve elektronike dhe programeve përbëjnë mbivendosje të detyrave dhe shërbimeve të specialisteve IT*

*Grupi auditimit mban të njëjtin qëndrim.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

- z. AH anëtar i grupit të specifikimeve teknike
- z.VC anëtar i grupit të specifikimeve teknike
- z. DK anëtar i grupit të specifikimeve teknike
- zj.EU anëtare e grupit të specifikimeve teknike
- zj.ET anëtare e njesisë së prokurimit
- z.ES anëtare e njesisë së prokurimit
- zj.MP anëtare e njesisë së prokurimit
- z.BZH anëtar i njesisë së prokurimit
- z.SL anëtar i njesisë së prokurimit

**Procedura me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe Serverëve për FSHN”**

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

|                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.</b> Urdhër Prokurimi: Nr. 1933/3 Prot., datë 14.10.2021                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>2.</b> Fondi Limit (pa tvsh)<br>12,050,433.30 lekë                                                                                                                                                                                                            | <b>3.</b> Hartuesit e specifikimeve teknike:<br>K shpk                                                                                                                                                    | <b>4.</b> Komisioni i llogaritjes se fondit limit:<br>K shpk                                                                                                                                                                     |
| <b>5.</b> Lloji i Procedurës së Prokurimit:<br>“Procedurë e hapur”                                                                                                                                                                                               | <b>6.</b> Hartuesit e Dokumenteve Tenderit:<br>ET<br>JGJ<br>MP                                                                                                                                            | <b>7.</b> Komisioni i Vlerësimit Ofertave:<br>EQ<br>ES<br>EZ                                                                                                                                                                     |
| <b>8.</b> Data e hapjes së tenderit: <b>10.02.2022</b>                                                                                                                                                                                                           | <b>9.</b> Operatori fitues: “P”<br>Vlera e ofertës fituese, pa TVSH,<br>11,949,140 lekë                                                                                                                   | <b>10.</b> Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 101,293.3 lekë                                                                                                                                                                    |
| <b>11.</b> Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender:<br>2 (dy)                                                                                                                                                                                                 | <b>12.</b> Operatore te Kualifikuar:<br>1(një)                                                                                                                                                            | <b>13.</b> Operatorë të skualifikuar:<br>1 (një)                                                                                                                                                                                 |
| <b>14.</b> Ankimimet:<br>-Shkresa nr. 1933/6, datë 02.11.2021 OE “ABS” shpk ka dërguar ankesë drejtuar AK dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilën ka parashtruar ankesa për 18 nga kërkesat që ka kërkuar AK për zhvillimin e procedurës së prokurimit. | <b>15.</b> Përgjigje Ankesës nga AK<br>- Vendimi nr. 1933/8, datë 08.11.2021 i;<br>- Shkresa nr. 1933/13 Prot. datë 9.12.2021;<br>- AK ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1933/15 Prot, datë 17.12.2021; | <b>16.</b> Përgjigje Ankesës nga KPP:<br>- Shkresa nr. 4201 Prot. datë 6.12.2021;<br>- KPP ka bërë kërkesë për paraqitje dokumentacioni për UT, me shkresën nr. 1933/14 Prot. datë 16.12.2021;<br>- Vendimi nr. 1030/2021 i KPP; |

|                                          |                                                                                                                                                                           |                                                                                             |
|------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                          | - Shkresa nr. 1933/18 Prot. datë 29.12.2021;<br>- AK ka vënë në dijeni KPP me shkresën nr. 1933/20 Prot. datë 17.01.2022;<br>- Shkresa nr. 1933/22 Prot. datë 28.01.2022. | - Vendimi nr. 13/2022 KPP;<br>- Vendimi nr. 74/2022 i KPP;<br>- Vendimi nr. 122/2022 i KPP. |
| 17. Marrja në Dorëzim<br>Datë 06.06.2022 | 18. Vlera e kontratës (me tvsh):<br>14,338,968 lekë                                                                                                                       | 19. Afati i kontratës: 90 Ditë                                                              |

Nga auditimi u konstatua:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:** Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në për llogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:** Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

- Operatori ekonomik: “P” shpk i ka plotësuar kriteret e DT, në këto kushte KVO e ka kualifikuar ofertën e OE.

- Operatori ekonomik: “A” shpk nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e DT për shkak se nuk ka dorëzuar dokumentacionin e plotë të kërkuar nga AK. Ky OE nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës si dhe vetëdeklarimin për garancinë e mallrave. Oferta e paraqitur nga ky operator ekonomik është më e lartë se fondi limit i procedurës. Autorizimet e paraqitura nga OE nuk janë të përkthyer si dhe nuk janë noterizuar. Për sa më sipër KVO e ka refuzuar kërkesën e këtij operatori ekonomik.

**-Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:**

- Me Urdhrin nr. 67/2, datë 09.03.2022 të Administratorit është ngritur komisioni për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të përbërë nga BZH EH dhe VF.

- Më datë 05.07.2022 në Rektoratin e UT është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim.

#### **Zhvillimi i kontratës:**

Me shkresën nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 Administratori i FSHN i ka dërguar preventivin dhe specifikimet teknike Administratorit të UT. FSHN ka sqaruar se ashtu siç kanë argumentuar në buxhetin vjetor, investimi ka ardhur si nevojë e rinovimit të rrjetit ekzistues. Vlera e preventivit që është dërguar nga FSHN është 9,700,000 lekë, dukshëm një vlerë më e ulët se planifikimi fillestar në buxhet i këtij projekti, i cili ishte në vlerën 14,500,000 lekë. Sipas argumentimit të FSHN ka ardhur pasi janë konstatuar pasaktësi në vlerësimin paraprak që ishte bërë për efekt të buxhetit por janë rishikuar edhe zgjidhje teknike të verifikuara në terren të cilat kanë dhënë efekte në uljen e preventivit dhe në përmirësimin e infrastrukturës së fakultetit. Në vlerën e miratuar ishte përfshirë edhe ndërtimi i një Website të ri dinamik me vlerë 2,000,000 lekë por duke qenë se ishin në përfundim të afatit të aksesit të faqes ekzistuese në

google, nga FSHN për këtë ëbsite është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh në fakultet. Për sa më sipër, vlera e planifikuar për këtë është konsideruar si e ezauruar duke e zbritur shumën nga planifikimi fillestar.

*- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit nuk ka një shkresë në të cilën UT të argumentojë një arsye pse nuk është marrë parasysh shkresa nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 e dërguar nga FSHN për preventivin e specifikimeve teknike.*

Procedura e blerjes me “KEJSI” shpk me vlerë 100,000 lekë është shpenzim pa efektivitet, pa marrë në konsideratë preventivin e dërguar nga FSHN.

Fondi limit i përlogaritur nga FSHN është në vlerën 8,083,500 lekë pa TVSH dhe në vlerën 9,700,200 lekë me TVSH. Ndërsa fondi limit i përlogaritur nga subjekti “K” shpk është në vlerën 12,050,433.30 pa TVSH dhe në vlerën 14,460,519.96 me TVSH.

Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve në UT, me shkresën nr. 1933/1 Prot. datë 12.07.2021 i ka drejtuar një kërkesë subjektit “K” shpk, me një procedurë blerje me vlerë 100,000 lekë, për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe projekt – preventivit me objekt “Instalim dhe rinovim i rrjetit të internetit” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me fond limit 12,050,433.30 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 1933/2 Prot. datë 08.10.2021, subjekti “K” shpk, ka dërguar dokumentacionin përkatës ku përfshihen preventivi si dhe specifikimet teknike.

Projekti, specifikimet teknike dhe preventivi nëpërmjet të cilit është përcaktuar fondi limit, janë hartuar në mbështetje të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP-së nga subjekti i licensuar “K” shpk, i cili ka përcjellë dokumentacionin me shkresën protokolluar pranë UT-së me nr 1933/2 Prot. datë 08.10.2021.

Me shkresën nr. 1933/3 Prot. datë 14.10.2021 ka dalë urdhër prokurimi nr.66, datë 14.10.2021 në të cilën është përcaktuar kryerja e prokurimit publik me fond 12,050,433.30 lekë pa TVSH me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe Serverave për FSHN-në”. Njësia e prokurimit përbëhet nga ET, JGJ dhe MP.

Me shkresën nr. 1933/4 Prot. datë 14.10.2021 ka dalë urdhri nr. 67, datë 14.10.2021 nga Administratori për “Ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt ‘F.V i rrjetit të internetit dhe Serverave për FSHN-në’”. Komisioni përbëhet nga EQ, ES dhe EZ.

Më datë 25.10.2021 në Rektoratin e UT është mbajtur procesverbali për hartimin dhe miratimin e DT me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe Serverëve për FSHN-në” me fond limit në vlerën 12,050,433.30, vënë në dispozicion nga të ardhurat e institucionit.

Shkresa nr. 1933/6 Prot. datë 02.11.2021 OE “ABS” shpk ka dërguar ankesë drejtuar AK dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilën ka parashtruar ankesa për 18 nga kërkesat që ka kërkuar AK për zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Urdhri nr. 67/1 Prot. datë 3.11.2021 i Administratorit ka vendosur pezullimin e procedurës derisa ankesa e OE “ABS” shpk të shqyrtohet në përputhje me LPP. Për shqyrtimin e ankesës është shqyrtuar komisioni EQ, ES dhe EZ.

Vendimi nr. 1933/8 Prot. datë 08.11.2021 i Administratorit ka vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga OE “ABS” shpk. Anëtarët e KSHA-së, kanë refuzuar ankesën e “ABS” shpk, duke i kthyer përgjigje me shkresën nr. 1933/9 datë 08.11.2021.

Me shkresën nr. 1933/10 Prot. datë 09.11.2021 Autoriteti Kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për shqyrtimin e ankesës nga OE “ABS” shpk për DT si dhe për refuzimin e saj. AK ka sqaruar se i është përgjigjur kërkesave për sqarim nga ana e operatorit ekonomik dhe se procedura ka vijuar të jetë e pezulluar deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga KPP.

Me shkresën nr. 4201 Prot. datë 6.12.2021 Komisioni i Prokurimit Publik ka njoftuar Universitetin e Tiranës dhe Operatorin Ekonomik “ABS” shpk, se ka gjykuar si të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore më 06.12.2021.

Me shkresën nr. 1933/13 Prot. datë 9.12.2021, Universiteti i Tiranës ka dërguar informacion për KPP, kanë dhënë përgjigje për ankesat e OE pas seancës dëgjimore si dhe nga ekspertiza e kompanisë së kontraktuar për specifikimet teknike.

KPP ka bërë kërkesë për paraqitje dokumentacioni për UT, me shkresën nr. 1933/14 Prot. datë 16.12.2021, ku sqaron se pas seancës dëgjimore të zhvilluar më 06.12.2021 është shprehur së AK i ka kthyer përgjigje KPP por nuk i ka vënë në dispozicion dokumentacionin mbi mënyrën e llogaritjes së fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP i ka kërkuar AK ti vërë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar brenda dy ditëve nga marrja e shkresës.

AK ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1933/15 Prot, datë 17.12.2021 ku ka sqaruar se për procedurën e prokurimit me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në” fondi limit është 12,050,433.30 lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor i është drejtuar një subjekti të licensuar projektues “K” shpk për hartimin e specifikimeve teknike dhe projekt preventiv të duke parashikuar procedurë blerje me vlerë 100,000 lekë.

Vendimi nr. 1030/2021 i Komisionit të Prokurimit Publik, ka vendosur të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ABS” shpk dhe ka kërkuar nga AK që të bëjë sqarimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e KPP, si dhe ti publikojë të gjitha ndryshimet në sistemin Elektronik të Prokurimeve.

Me shkresën nr. 1933/18 Prot. datë 29.12.2021 AK ka vënë në dijeni KPP se në zbatim të vendimit, janë bërë sqarimet e nevojshme për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Vendimi nr. 13/2022 i Komisionit të Prokurimit Publik ka vendosur të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin e procedurës së prokurimit me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në”.

AK ka vënë në dijeni KPP me shkresën nr. 1933/20 Prot. datë 17.01.2022 se në zbatim të vendimit nr. 13/2022 dhe nenit 7 të LPP-së, ka bërë sqarime mbi shtojcën nr.2 të DT, për të gjithë OE e interesuar për të marrë pjesë në procedurë.

Vendimi nr. 74/2022 i Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit të çështjes ka vendosur të mos lejojë autoritetin kontraktor me vijimin e procedurës me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në”.

Më tej AK i ka dërguar KPP shkresën nr. 1933/22 Prot. datë 28.01.2022 për vënie në dijeni mbi zbatimin e vendimit nr. 74/2022 të KPP ku sqaron se ka bërë sqarimet e nevojshme mbi shtojcën nr.3 të DT, për të gjithë OE e interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Vendimi nr. 122/2022 i KPP pas shqyrtimit të çështjes vendosi të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në”.

Me vendimin nr. 1933/24 Prot. datë 4.2.2022 i Administratorit të UT është hequr pezullimi i procedurës me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në”, në zbatim të vendimit nr. 122/2022, të KPP.

Më 17.02.2022, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës u mbajt procesverbali për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në procedurën me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në”. Për këtë procedurë paraqitën interes dy operatorë ekonomikë:

1. OE “P” shpk, ka paraqitur ofertën me vlerë 11,949,140 lekë pa TVSH;

2. OE “A” shpk, ka paraqitur ofertën me vlerë 31,317,680 lekë pa TVSH.

- Vendimi nr. 1933/27 Prot. datë 01.03.2022 i Administratorit të UT shpalli OE “P” shpk fitues të procedurës me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në” me vlerë të ofertës 11,949,140 lekë pa TVSH.

Kontrata e furnizimit për “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në” ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe OE “P” shpk u lidh me shkresën nr. 1933/28 Prot. datë 09.03.2022.

Urdhri nr. 67/2, datë 09.03.2022 i Administratorit për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe serverëve për FSHN-në”, ngriti komisionin e përbërë nga EM, BZH dhe VF.

- 4. Titulli i gjetjes:** UT nuk ka një shkresë në të cilën të argumentojë pse nuk është marrë parasysh shkresa nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 e dërguar nga FSHN për preventivin e specifikimeve teknike.
- Situata:** Me shkresën nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 Administratori i FSHN i ka dërguar preventivin dhe specifikimet teknike Administratorit të UT. FSHN ka sqaruar se ashtu siç kanë argumentuar në buxhetin vjetor, investimi ka ardhur si nevojë e rinovimit të rrjetit ekzistues. Vlera e preventivit që është dërguar nga FSHN është 9,700,000 lekë, dukshëm një vlerë më e ulët se planifikimi fillestar në buxhet i këtij projekti, i cili ishte në vlerën 14,500,000 lekë. Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve në UT, me shkresën nr. 1933/1 Prot. datë 12.07.2021 i ka drejtuar një kërkesë subjektit “K” shpk, me një procedurë blerje me vlerë 100,000 lekë, për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe projekt – preventivit me objekt “Instalim dhe rinovim i rrjetit të internetit” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me fond limit 12,050,433.30 lekë pa TVSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit nuk ka një shkresë në të cilën UT të argumentojë një arsye pse nuk është marrë parasysh shkresa nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 e dërguar nga FSHN për preventivin e specifikimeve teknike.
- Ndikimi/Efekti:** Rritje të shpenzimeve dhe kostove të cilat bien në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efijencës.
- Shkaku:** Mos marrja në konsideratë e preventivit dhe specifikimeve teknike të përllogaritura nga FSHN.
- Kriteri:** Shkresa nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 e dërguar nga FSHN për preventivin e specifikimeve teknike.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës në të ardhmen në rastet e ngjashme të shqyrtojë me kujdes dhe të hartojë memo ku të paraqesë argumente për marrjen ose jo në konsideratë të kërkesave mbi përcaktimin e specifikimeve teknike.

- 5. Titulli i gjetjes:** Universiteti i Tiranës nuk ka marrë në konsideratë vlerësimin e buxhetit nga FSHN mbi ndërtimin e një website me vlerë 2,000,000 lekë pa TVSH

**Situata:** Administratori i FSHN ka dërguar preventivin dhe specifikimet teknike me shkresën nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 ku vlera e preventivit është 9,700,000 lekë, dukshëm një vlerë më e ulët se planifikimi fillestar në buxhet i këtij projekti, i cili ishte në vlerën 14,500,000 lekë. FSHN ka argumentuar se janë konstatuar pasaktësi në vlerësimin paraprak që ishte bërë për efekt të buxhetit por janë rishikuar edhe zgjidhje teknike të verifikuara në terren të cilat kanë dhënë efekte në uljen e preventivit dhe në përmirësimin e infrastrukturës së fakultetit. Në vlerën e miratuar ishte përfshirë edhe ndërtimi i një website të ri dinamik me vlerë 2,000,000 lekë por duke

qenë se ishin në përfundim të afatit të aksesit të faqes ekzistuese në google, nga FSHN për këtë website është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh në fakultet. Për sa më sipër, vlera e planifikuar është konsideruar si e ezauruar duke e zbritur shumën nga planifikimi fillestar.

- Ndikimi/Efekti:** Rritje të shpenzimeve dhe kostove të cilat bien në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efijencës.
- Shkaku:** Diferenca ndërmjet vlerës së përllogaritur nga FSHN dhe vlerës së kontratës ka çuar në rritje të fondit limit.
- Kriteri:** Shkresa nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 e dërguar nga FSHN për preventivin e specifikimeve teknike.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të nxjerrë përgjegjësitë dhe të kërkohet ndjekja e procedurave të nevojshme administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin e vlerës 2,000,000 lekë pa TVSH mbi ndërtimin e një website për FSHN ndërkohë që vetë fakulteti ka sqaruar se për këtë website është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh dhe vlera është konsideruar si e ezauruar duke e zbritur vlerën nga planifikimi fillestar i buxhetit.

- 6. Titulli i gjetjes:** Shpenzime jo efektive për buxhetin.e Universitetit
- Situata:** Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve në UT, me shkresën nr. 1933/1 Prot. datë 12.07.2021 i ka drejtuar një kërkesë subjektit “K” shpk, me një procedurë blerje me vlerë 100,000 lekë, për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe projekt – preventivit me objekt “Instalim dhe rinovim i rrjetit të internetit” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me fond limit 12,050,433.30 lekë pa TVSH. Preventivi dhe specifikimet teknike të dërguara nga FSHN nuk janë marrë parasysh dhe për pasojë blerja e procedurës me vlerë 100,000 lekë është shpenzim pa efektivitet.
- Ndikimi/Efekti:** Rritje të shpenzimeve dhe kostove të cilat bien në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efijencës.
- Shkaku:** Mos marrja në konsideratë e preventivit dhe specifikimeve teknike të përllogaritura nga FSHN.
- Kriteri:**
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Titullari i autoritetit kontraktor, në vijimësi të marri masa mbi organizimin e procedurave të prokurimit ku të analizojë dhe argumentojë nevojën për përdorimin e tyre në mënyrë që në të ardhmen të shmanget përdorimi pa efektivitet i fondeve.

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 6, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me shkresën nr. 1522/7 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/12, datë 07.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 468/15, datë 05.12.2022.*

**Pretendimi i subjektit:**

.... Sa më sipër, Universiteti i Tiranës ka të miratuar “Strategji të zhvillimit të UT-së” për vitin 2018-2023. .. Në lidhje me konstatimin e audituesve obserojmë sikurse kemi sqaruar edhe më lart se në buxhetin e dërguar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, kërkesa fillestare dhe e miratuar në Buxhetin e konsoliduar të UT-së, është në shumën 14,500,000 lekë me tvsh për objektin “F.V. i rrjetit të internetit dhe serverave për FSHN”. Administratori i UT-së, si nëpunësi autorizues institucionit shqyrton buxhetin e dërguar nga fakultetet bazuar në të drejtën e rishikimit në mënyrë që të sigurojë përputhjen me politikat zhvilluese të UT-së dhe PBA 3-vjecare, mbi këtë bazë do të paraqesë buxhetin e konsoliduar të UT-së për vitin buxhetor aktual për miratimin të mëtejshëm në Senatin Akademik Ut-së dhe në Bordin e Administrimit UT-së. dhe duke mbajtur parasysh që Administratori i UT-së, si nëpunësi autorizues i institucionit ka detyrim që çdo ndryshim në zërat e buxhetit duhet ti aprovojë në organet vendimarrëse (BA), i lind detyrimi për një përcaktim më të saktë të fondit të përllogaritur për një objekt me natyrë specifike që kërkon njohuri fushe përkatëse elektrike dhe elektronike, të ngrejë grupe pune ose të kontraktojë nga jashtë institucionit në rast mungese të stafit specialist të fushës për të bërë verifikimet për përllogaritjen e saktë të fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Përsa më sipër, ndodhur përpara kësaj mospërputhje në shumën e parashikuar, Administratori i UT-së me të drejtën që ja jep Ligji së i është drejtuar një subjekti projektues i licencuar “KEJSI-05” shpk, duke përdorur një procedurë prokurimi mbështetur në LPP, procedurë deri në 100,000 Lekë pa tvsh, i cili i ka përcjellë dokumentacionin me shkresën protokolluar pranë UT-së me nr.1933/2, datë 08.10.2021, përkatësisht projektin, specifikimet teknike të cilat janë hartuar në mbështetje të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të LPP, si dhe preventivin, nëpërmjet të cilit është përcaktuar fondi limit, nga ku ka rezultuar që për këtë objekt kontrate është I nevojshëm një fond prej 12,050,433.3 lekë pa tvsh dhe jo 9,700,000 lekë pa tvsh, siç shprehet Administratori i Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Sikurse kemi theksuar edhe më lart përcaktimi i drejtë i fondit limit Situata e mësipërme vërtetohet edhe nga korrespondenca me shoqërinë “ABS” shpk dhe Komisionin e Prokurimit Publik, ku OE në ankesën protokolluar me nr.1933/6, datë 02.11.2021 ka kërkuar dhe ka pretenduar se me kërkesat e paraqitura, fondi limit për këtë kontratë duhej të ishte mbi 12,050,433.3 lekë pa tvsh.

KPP në vendimin nr.1030/2021, datë 22/12/2021 në lidhje me ankesën e paraqitur nga OE, shprehet se “...Sa më lart KPP vëren se për rastin konkret Autoriteti Kontraktor e ka përcaktuar fondin limit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe si rezultat nuk cënon interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomik në kuptim të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përsa më sipër pretendimi i OE nuk qëndron” (Bashkëngjitur Vendimi i KPP-së)

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Ashtu sikundër ju e keni përmendur kërkesa fillestare dhe e miratuar në Buxhetin e konsoliduar të UT-së, është në shumën 14,500,000 lekë me TVSH por vetë fakulteti ka sqaruar se janë vërejtur pasaktësi në planifikimin fillestar mbi buxhetin e projektit. Gjithashtu, në vlerë ishte parashikuar edhe ndërtimi i një website të ri por vetë fakulteti ka argumentuar se për website-in është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh dhe në kohën që shkresa i është dërguar rektoratit faqja ka qenë duke u përfunduar. Ky është tregues se vlera 2,000,000 lekë pa TVSH për këtë website ka qenë e ezauruar.

Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:**

z.SD, me detyrë Administrator i Universitetit të Tiranës.

### 3. Mbi Auditimin e Sigurisë së Informacionit, në Universitetin e Tiranës.

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij.

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: *“Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”*.

#### a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit

Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktiviteteve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

Universiteti i Tiranës si institucion publik i arsimit të lartë, ofron arsimin e lartë, zhvillimin e dijeve, të shkencës, të inovacionit dhe të profesioneve. Po ashtu UT-ja ofron një gamë të plotë të programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, të ciklit të dytë “Master”, si dhe të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” dhe të doktoratës.

Për periudhën objekt auditimi Universiteti i Tiranës ka patur dhe ka në përdorim një platformë të Microsoft, konkretisht Office 365 edu (Free Microsoft Office 365 for Schools & Students). Gjithashtu Universiteti i Tiranës ka përdorur platformat Microsoft Office 365 edu, dhe Microsoft Teams për menaxhimin e informacionit të mësimdhënies në distance.

Nevoja për përdorimin e këtyre platformave lindi si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia SARS-COV2 dhe vendimet e Komitetit Teknik që viti akademik 2020-2021 në institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik, të zhvillohet on line deri në një afat të dytë.

Në fakt platforma Microsoft Office 365 education, është përdorur në Universitetin e Tiranës që në vitin 2013 dhe është konfiguruar në kuadër të një shtese dhe ndryshim të Vendimit nr. 762, datë 01.09.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e marrëveshjes së rinovuar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “Microsoft corporation”*, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit”. Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 21.10.2020 ka marrë vendimin për përdorimin e unifikuar të sistemit digjital të mësimin në distancë, platformës Microsoft Teams. Kjo platformë mundëson krijimin e grupeve dhe klasave virtuale nga ana e personelit akademik me qëllim shkëmbimin e informacionit (*chat, call apo video call conference*). Mund të organizojë provime, testime apo pyetësor të ndryshëm duke monitoruar aksesin e secilit student, kohën në dispozicion si dhe të dërgojë rezultatet në kohë reale. Microsoft Teams mund të download-ohet dhe instalohet në çdo sistem operimi Windows,

Android, IOS. Gjatë vitit 2020 dhe në vijim nga ana e Universitetit të Tiranës janë përfituar të gjitha shërbimet Cloud të Microsoft Education, sipas marrëveshjes Microsoft Online Subscription Agreement.

### ***Procedura e backup-it***

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Universiteti i Tiranës duke qenë se për periudhën objekt auditimi ka patur dhe ka në përdorim platformat të Microsoft Office 365 edu (*Free Microsoft Office 365 for Schools & Students*), procedurat e backup kryhen në mënyrë automatike në Cloud nga Microsoft sipas politikave të paracaktuara nga Microsoft.

Për periudhën 2020-2021 UT nuk ka pasur një sistem informatik për të cilin duhet të realizonte proceset e backup-it. Procedurat e backup-it janë realizuar automatikisht vetëm për faqen e web-it të UT-së dhe nuk transferohen.

### ***Active Directory***

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se UT për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet ka në përdorim platformën Microsoft Office 365 edu, e cila ka të integruar “*Azure Active Directory*”.

### ***Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat***

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë, është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe azhurnimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar që ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Biznesit. Vazhdueshmëria a biznesit (BCP) është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje.

Auditimi mbi ofrimin e Vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve, u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar, risqeve të identifikuara dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je: “*Çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbimit të informacionit për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave*”. Në këtë VKM cilësohet gjithashtu edhe dokumentimi i politikave mbi planin e vazhdueshmërisë së punës dhe rikuperimit nga katastrofat, si dhe të bëhet i mundur evidentimi i sistemeve të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24/7.

Universiteti i Tiranës, si institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor që është duke investuar<sup>1</sup> në një sistem informatik që ruan, përpunon dhe gjeneron të dhëna me rëndësi për menaxhimin dhe organizimin e procesit dhe kontrollin e mësimdhënies, nuk ka marrë masa sa më poshtë.

---

<sup>1</sup> Gjatë periudhës së zhvillimit të auditimit në terren në UT është duke u zhvilluar dhe implementuar një sistem informatik për menaxhimin dhe organizimin e procesit dhe kontrollin e mësimdhënies në UT.

*Nga auditimi u konstatua se, UT :*

Nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtërimit*) për çdo proces kritik.

***Kontrollet e aksesit politikat e aksesit menaxhimi i privilegjeve përdorimi i TI në krijimin e kushteve fizike në UT.***

Posedimi i kontrollit të aksesit është i rëndësishëm kur personat kërkojnë në informacion ose pajisje të rëndësishme, konfidenciale ose sensitive. Në një mjedis shtetëror, kontrolli i aksesit është i rëndësishëm sepse shumë subjekte publike përpunojnë të dhëna sensitive dhe çështjet e privatësisë limitojnë se cilët persona duhet të shohin pjesë të ndryshme të informacioni.

Politikat e aksesit japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve të institucionit. Funksioni i Sigurisë së Informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në kohë dhe raporton efikasitetin dhe efektivitetin e operimit.

*Nga auditimi u konstatua se* hyrja kryesore e Rektoratit të UT nuk është e kontrolluar nga një sistem të veçantë aksesit, hyrje daljet e punonjësve të UT nuk ruhen dhe nuk monitorohen pasi nuk kanë të instaluar një sistem aksesit të hyrje - daljeve duke kompromentuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.

***Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve***

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Duke mos realizuar identifikimin e risqeve, universiteti rrezikon që risqet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve etj. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që institucioni të mos identifikojë risqet me efekt negativ në IT dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim dhe mos lënie gjurmësh për trajtimin e gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e IT.

*-Menaxhimi i ndryshimeve.*

Nga auditimi u konstatua se UT nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.

***b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet***

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të IT në UT, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e dytë të Rektoratit ku është hostuar rack-u me serverat.

*Nga auditimi u konstatua se:*



Ambienti fizik i dhomës së serverëve ku janë hostuar serverat nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (*Versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI (*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit*), përkatësisht:

Nga auditimi i kushteve dhe karakteristikave teknike të ndërtimit të dhomës së serverit u konstatua se:

Ambienti ku janë vendosur serverat dhe pajisjet e network, switch dhe routera është një zyrë e përshtatur si dhomë serverash, duke mos plotësuar kushtet teknike për tu klasifikuar si një dhomë serverash.

- a. Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- b. Dhoma nuk përbëhet nga një dysheme teknologjike në të cilën të jetë e parashikuar pesha e rack-eve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen në të dhe nuk ka pendence në drejtim të derës së dhomës së serverëve;
- c. Dhoma e serverëve nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;
- d. Dhoma e serverëve nuk përmban kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës. Ftohja e dhomës realizohet me anë të kondicionerit të thjeshtë;
- e. Dhoma e serverëve nuk plotëson kushtet teknike lidhur me kapacitetin dhe cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- f. Në dhomën e serverëve mungon sistemi i alarmit dhe hyrja në dhomë nuk është e siguruar me anë të një sistemi elektronik dhe sistem alarmi në rast thyerje të saj; në kundërshtim me pikën 4.1, 4.3, 4.4, 4.5 dhe 4.6 të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.
- g. Nga auditimi i pajisjeve të cilat janë vendosur në dhomën e serverit rezultoi se rack-u i vendosur nuk është i mbrojtur kundër lëkundjeve sizmike, nuk ka hapësirë përpara apo anash tij sipas përcaktimeve të prodhuesit, në kundërshtim me pikën 4.2 të rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.
- h. Nga auditimi i procedurës së administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një sistem access-i që rregullon hyrje-daljet.
- i. Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj.

*Foo nga ambienti fizik i dhomës së serverëve*




### ***Auditimi mbi pajisjet router dhe infrastruktura e networkut***

Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar on-site infrastruktura network e institucionit. Komunikimi me fakultetet, realizohet me fibër optike. UT ka ngritur një infrastrukturë të zgjeruar network në qendër e në fakultete.

Menaxhimi dhe suporti i pajisjeve elektronike, të cilat bëjnë të mundur komunikimin në rrjet *online*, si kompjutera, printera, fotokopje dhe pajisje mbështetëse të rrjetit LAN, në Rektorat, kanë rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e punës të secilit anëtar të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të UT-së.

### ***Topologjia e infrastrukturës së ndërtuar Hardware/Software/Network:***

Topologjia e networkut është e tipit yll (star) network, përbëhet nga kompjutera për përdorim personal dhe rrjeti i brendshëm kompjuterik, nëpërmjet të cilit aksesohet interneti. Me anë të këtij rrjeti aksesohen shërbimet e tjera on-line që ofrohen për UT.



### Shërbimi network:

Universiteti i Tiranës e merr shërbimin e internetit nga Qendra Ndërinstitucionale “Rrjeti Akademik Shqiptar” RASH. Ky shërbim ofrohet me anë të rrjetit GEANT në kuadër të zbatimit të VKM nr. 88, datë 14.02.2018, pika 4, ç. Edhe përgjatë vitit 2021 shërbimi i internetit është ofruar nga RASH.

Konektiviteti inside/outside garantohej nga RASH (Qendra Ndërinstitucionale “Rrjeti Akademik”) dhe Rektorati i UT-së, ka të ngritur infrastrukturën e tij, ku gjendet i hostuar firewall hardware CISCO ASA 5510, antivirus Sophos Endpoint Agent për përdoruesit e menaxhueshëm me anë të consol claud si dhe, Microsoft 365 Admin Center (Security; Defender; Azure Active Directory).

Çdo pajisje e vendosur në rrjetin e UT-së, regjistrohet në domain-in *unitir.edu.al* dhe është e identifikuar me ip, mac adres serial number si dhe personelin përgjegjës. Çdo përdorues ka llogarinë e tij të aksesimit të pajisjes kompjuterike sistemeve të përdorimit office 365, me të dhëna user password sipas politikave: të ketë minimumi 8 karaktere (gërmë të madhe, gërmë të vogël, numër si dhe karakter) gjithashtu përdoret Multifactor Authentication Security për përdoruesit administrator.

*Nga auditimi u konstatua:*

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në UT mbështeten në një infrastrukture network jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar.

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me shkresën nr. 1522/3 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në faqet 44-55 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/13, datë 07.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 468/16, datë 07.12.2022.*

*Në shkresën e sipërpërmendur subjekti i audituar ka sjellë observacione mbi gjetjet e trajtuara, që janë të njëjta në thelb dhe në përmbajtje me observacionet e bëra mbi aktkonstatimin e mbajtur, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në Projektraport se, ato nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, por në fund subjekti shprehet se, këto gjetje janë pranuar dhe do të marrë masat përkatëse për plotësimin e rekomandimeve.*

- 1.Titulli i gjetjes:** Planet e vazhdimësisë së punës dhe procedurat e backup.
- Situata:** Nga auditimi u konstatua se UT nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar.
- Kriteri:** VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar, dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare (COBIT dhe Manuali i Auditimit IT).
- Ndikimi/efekti:** Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.
- Shkaku:** Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Universitetin e Tiranës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës
- 2.Titulli i gjetjes:** Mungesa e monitorimit të hyrje - daljeve me anë të sistemeve elektronike, në ambientet fizike të Rektoratit
- Situata:** Nga auditimi u konstatua se hyrja kryesore e Rektoratit të UT nuk është e kontrolluar nga një sistem të veçantë aksesit, hyrje daljet të punonjësve të UT nuk ruhen dhe nuk monitorohen pasi nuk kanë të instaluar një sistem aksesit të hyrje-daljeve duke kompromentuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.
- Kriteri:** Sigurimi se masat organizative dhe fizike garantojnë parandalimin e aksesit të paautorizuar.
- Ndikim/Efekti:** Risk për akses të pa autorizuar.
- Shkaku:** Nuk janë marrë masat e nevojshme administrative për akses të sigurt duke mos zbatuar praktikat më të mira.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi:** UT të analizojë nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e rektoratit dhe marrjen e masave shtesë në qoftë se e gjykon të arsyeshme, me qëllim

kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar që nuk janë pjesë e administratës por edhe për të administruar hyrje daljet e stafit të administratës së rektoratit

**3.Titulli i gjetjes:** Mos menaxhim i incidenteve dhe ndryshimeve, dhe mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.

**Situata:** Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Tiranës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

**Ndikimi/efekti:** Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.

**Shkaku:** Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese në Universitetin e Tiranës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

**4.Titulli i gjetjes:** Dhoma e serverave dhe infrastruktura network nuk plotësojnë standardet e përcaktuara dhe mbështeten në një infrastrukture IT (rrjeti network) të amortizuar.

**Situata:** -Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve në Universitetin e Tiranës nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.  
-Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në UT mbështeten në një infrastrukturë network jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar.

**Kriteri:** Garantimi i sigurisë fizike dhe ambientale është në përputhje me kërkesat për siguri dhe me klasifikimin e sensitivitetit të aseteve IT. Garantimi se ndërhyrjet zbulohen dhe trajtohen (Politika të brendshme të sigurisë).

Rregulloren e miratuar nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve” (versioni 1.0, datë 02.12.2008

**Ndikimi/efekti:** Cënim i sigurisë, hyrje e paautorizuara dhe risk humbje të të dhënave  
**Shkaku:** Mungesa e investime në infrastrukturë dhe mos zbatim i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukture IT (ambienteve të dhomës të serverëve dhe rrjetin network) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të

TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

#### **4. Auditimi i Sistemeve**

##### **a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output**

UT si institucion publik i arsimit të lartë, ofron arsimin e lartë, zhvillimin e dijeve, të shkencës, të inovacionit dhe të profesioneve. Po ashtu UT ofron një gamë të plotë të programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, të ciklit të dytë “Master”, si dhe të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” dhe të doktoratës. Gjithashtu ai kontribuon në zhvillimin e shoqërisë përmes tre shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik, kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut.

Për periudhën objekt auditimi Universiteti i Tiranës ka patur dhe ka në përdorim një platformë të Microsoft, konkretisht Office 365 Education (Free Microsoft Office 365 for Schools & Students). Universiteti i Tiranës ka përdorur platformat Microsoft Office 365 Education, dhe Microsoft Teams për menaxhimin e informacionit të mësimdhënies në distancë.

Nevoja për përdorimin e këtyre platformave lindi si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia SARS-COV2 dhe vendimet e Komitetit Teknik që viti akademik 2020-2021 në institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik, të zhvillohet on line deri në një afat të dytë.

Platforma Microsoft Office 365 education, është përdorur në Universitetin e Tiranës që në vitin 2013 dhe është konfiguruar në kuadër të një shtese dhe ndryshim të Vendimit nr.762, datë 1.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së rinovuar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “Microsoft corporation”, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit”.

Universiteti i Tiranës përdor të gjitha produktet e Microsoft të formës education, por jo vetëm edu, por edhe .gov dhe është pajisur me produkte të Microsoft nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Inovacionit).

Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e tij të datës 21.10.2020 ka marrë vendimin për përdorimin e unifikuar të sistemit dixhital të mësimin në distancë nëpërmjet platformës Microsoft Teams.

Kjo platformë mundëson krijimin e grupeve dhe klasave virtuale nga ana e personelit akademik me qëllim shkëmbimin e informacionit (*chat, call apo video call conference*). Mund të organizojë provime, testime apo pyetësor të ndryshëm duke monitoruar aksesin e secilit student, kohën në dispozicion si dhe të dërgojë rezultatet në kohë reale. Gjatë vitit 2020 dhe në vijim nga ana e Universitetit të Tiranës janë përfituar të gjitha shërbimet Cloud të Microsoft Education, sipas marrëveshjes Microsoft Online Subscription Agreement.

##### **Tipet e të dhënave hyrëse**

Të dhënat bazë emër, mbiemër, viti akademik, fakulteti, program studimi, cikli i studimit, përshkrimi i pozicionit (Student / Personel)

Formati i platformës csv ka të dhënat bazë i cili i ka të formatit ( *Text, Integer, Number, Date, general*)

*Microsoft Office 365 edu*, ka të integruara politika standarde në zbatim të GDPR. Gjithashtu Universiteti i Tiranës, ka krijuar politika të tij në platformë referuar në aktet e sipërcituara, për të drejtat e përdoruesve si administrator, përdorues me politika profesor dhe licence të dedikuara (*Office 365 edu faculty*), për përdorues me politika student me të drejta të kufizuara dhe licenca të dedikuara (*Office 365 edu student*).

### **Administratorët e sistemit UVMS**

Drejtori i IT, Përgjegjës sektori IT, Specialist IT sipas profileve:

- Global Administrator
- Administrator, Përgjegjës i Sektorit
- Helpdesk Administrator, Specialist IT
- Teams administrator, Përgjegjës, Specialist IT

Sipas informacionit të vënë në dispozicion, për periudhën objekt auditimi, UT ka patur në përdorim vetëm platformat e ofruara nga Microsoft.

UT e përfaqësuar nga rektori, *ka nënshkruar krijimin e Rrjetit Akademik Shqiptar – RASH dhe me anë të shkresës nr. 4700 prot., datë 09.11.2017, ku mbështetur në këtë marrëveshje është miratuar VKM nr. 88, datë 14.02.2018 për “Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.*

Mbështetur në pikat 3/ç dhe 4/a, qëllimi i RASH:

- 3/ç: Është zhvillimi i programeve software dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.

- 4/a: Kryen zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar.

|                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-----------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.Titulli i gjetjes:</b> | Universiteti i Tiranës nuk ka vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Situata:</b>             | Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Tiranës, nuk ka vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga RASH, megjithëse vet ky universitet ka nënshkruar dhe është bërë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit me Rrjetit Akademik Shqiptar.                                                                                                                                                                          |
| <b>Kriteri:</b>             | Pikat 3/ç dhe 4/a të VKM nr. 88, datë 14.02.2018 për “Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Ndikimi/efekti:</b>      | Mungesë të dhënash në sistemin Pitagora, një sistem i përmirësuar për t'i shërbyer studentëve sipas marrëveshjes që vetë universitetet kanë nënshkruar.                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Shkaku:</b>              | Mungesë angazhimi për të identifikuar, dokumentuar dhe raportuar mangësitë dhe zgjidhjet që vënë në funksion marrëveshjen.                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Rëndësia:</b>            | E lartë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Rekomandimi 1:</b>       | Universiteti i Tiranës, të analizojë, të identifikojë dhe të dokumentojë të gjitha arsyet teknike, financiare dhe ligjore për të cilat nuk kanë vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar, si një detyrim që rrjedh nga marrëveshja e nënshkruar ndërmjet universiteteve dhe RASH.                                                                                                        |
| <b>Rekomandimi 2:</b>       | Universiteti i Tiranës të adresojë në institucionet përgjegjëse që janë Ministria e Arsimit dhe RASH, çështjet që e kanë penguar të vërë në funksion sistemin Pitagora, në mënyrë që të nxiten të gjithë faktorët për qartësimin dhe saktësimin njëherë e mirë mbi të drejtën e zhvillimit të sistemeve informatike që ndërtohen në shërbim të studentëve në mënyrë që të parandalohen investime me qëllime të njëjta. |

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 30.09.2022, protokolluar në Universitetin e Tiranës me shkresën nr. 1522/3 datë 30.09.2022, si dhe është trajtuar në faqet 44-55 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1522/13, datë 07.12.2022, protokolluar në KLSH me nr. 468/16, datë 07.12.2022.

**Pretendimi i subjektit:** UT-ja nuk ka vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga RASH, megjithëse është bërë pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar për arsye se ka në përdorim sistemin informatik e-student, të vendosur në funksionalitet të plotë për vitin akademik 2022-2023. Sistemi Pitagora dhe sistemi E-student ofrojnë të njëjtat shërbime ndaj është vlerësuar që sistemi e-student plotëson nevojat për shërbimet që UT ofron për studentët sid he është pronë e UT që në vitin 2010. Po ashtu sistemi e-student ka përparësi pasi menahon të gjithë procesin akademik të një studenti sid he ofron dy shërbime nga portali e-albania: listë notash dhe vërtetim titullimi me firmë dhe vulë elektronike. Gjithashtu ndërvepron me sistemet govnet përkatësisht atë të gjendjes ciile me qëllim marrjen e të dhënave të sakta për studentët.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

UT nuk mund të veprojë me dy standarte, të zhvillojë sisteme për llogarinë e saj sa kohë ka nënshkruar një marrëveshje e cila është akt ligjor detyrues për respektim dhe për sa kohë nuk ka iniciuar asnjë hap për të identifikuar se cilat zera të VKM që do të respektojnë dhe cilat jo së bashku me argumentet përkatëse.

Nuk ka inicuar asnjë proces që VKM të ndryshojë për sa kohë ajo zbatohet pjesërisht.

Për sa më lart, gjetja qëndron dhe grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin. Mbajmë të njëjtin qëndrim dhe në lidhje me rekomandimin e dhënë për këtë çështje.

#### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Tiranës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit ose përfshirje të saj në strategjinë institucionale, duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, si dhe të marrë masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të përcaktuara.

##### ***Në vijimësi***

**2.Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi Universiteti i Tiranës nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2020 - 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Nuk dokumentohet procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për trajnim. Duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit i cili merret me administrimin e bazës së të dhënave dhe të çdo përdoruesi të sistemit, si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Tiranës nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ për sa i përket arritjes së objektivave institucionale.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të marrë masa për hartimin e regjistrit të riskut ku të përfshihen edhe risqet për Teknologjinë e Informacionit me qëllim identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4.Titulli i Gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se inicimi i procedurave të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor në dosjet e prokurimit të procedurave TIK për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, evidentuar të paktën në 7 raste nuk përmbajnë argumentim të nevojës për kryerjen e këtyre investimeve si dhe nuk kanë të bashkëlidhur Plan-Buxhetin së bashku me argumentimin përkatës, në të cilin të jetë parashikuar kryerja e këtyre investimeve / shpenzimeve, për nevojat e Universitetit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 17-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1.Rekomandim:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të ardhshme të prokurimit, t’i iniciojë këto procedura duke evidentuar kërkesat nga e Universitetit, arsyet dhe relacionet sipas planifikimeve në programet ekonomike të nevojave për investime/shpenzime.

### ***Menjëherë***

**5.Titulli i Gjetjes:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit TIK rezulton se në të paktën 4 procedura janë kërkuar kritere të veçanta kualifikimi jo në përputhje me objektin e prokurimit, konkretisht :

1)Procedura Blerje pajisje Elektronike, softje për përpunimin e të dhënave cilësore programe software, aplikacion për studentët, , sistem kamerash” viti 2020

2)“Blerje pajisje elektronike dhe audiovizuale për UT viti 2021

3)“Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2020.

4)Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2021

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 17-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që nga ana e grupeve të punës që do të ngrihen për hartimin e kritereve të kualifikimit për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen, të mos hartohen kritere që janë jashtë objektit të prokurimit.

### ***Menjëherë***

**6. Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se me shkresën nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 Administratori i FSHN i ka dërguar preventivin dhe specifikimet teknike Administratorit të UT. FSHN ka sqaruar se ashtu siç kanë argumentuar në buxhetin vjetor, investimi ka ardhur si nevojë e rinovimit të rrjetit ekzistues. Vlera e preventivit që është dërguar nga FSHN është 9,700,000 lekë, dukshëm një vlerë më e ulët se planifikimi fillestar në buxhet i këtij projekti, i cili ishte në vlerën 14,500,000 lekë. Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve në UT, me shkresën nr. 1933/1 Prot. datë 12.07.2021 i ka drejtuar një kërkesë subjektit “K” shpk, me një

procedurë blerje me vlerë 100,000 lekë, për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe projekt – preventivit me objekt “Instalim dhe rinovim i rrjetit të internetit” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me fond limit 12,050,433.30 lekë pa TVSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit nuk ka një shkresë në të cilën UT të argumentojë një arsye pse nuk është marrë parasysh shkresa nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 e dërguar nga FSHN për preventivin e specifikimeve teknike.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 17-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës në të ardhmen në rastet e ngjashme të shqyrtojë me kujdes dhe të paraqesë argumente për marrjen ose jo në konsideratë të kërkesave mbi përcaktimin e specifikimeve teknike.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se UT nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 51-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Universitetin e Tiranës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurtisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

***Në vijimësi***

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se hyrja kryesore e Rektoratit të UT nuk është e kontrolluar nga një sistem të veçantë aksesit, hyrje daljet të punonjësve të UT nuk ruhen dhe nuk monitorohen pasi nuk kanë të instaluar një sistem aksesit të hyrje-daljeve duke kompromentuar nivelin e sigurtisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 51-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** UT të analizojë nivelin e sigurtisë së aksesit në ambientet e rektoratit dhe marrjen e masave shtesë në qoftë se e gjykon të arsyeshme, me qëllim kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar që nuk janë pjesë e administratës por edhe për të administruar hyrje daljet e stafit të administratës së rektoratit.

***Në vijimësi***

**9.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Tiranës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 51-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese në Universitetin e Tiranës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**10.Gjetje nga auditimi:**

-Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve në Universitetin e Tiranës nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

-Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në UT mbështeten në një infrastrukturë network jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 51-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1.Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukturë IT (ambienteve të dhomës të serverëve dhe rrjetin network) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Tiranës, nuk ka vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga RASH, megjithëse vet ky universitet ka nënshkruar dhe është bërë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit me Rrjetin Akademik Shqiptar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 59-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës, të analizojë, të identifikojë dhe të dokumentojë të gjitha arsyet teknike, financiare dhe ligjore për të cilat nuk përdorin sistemin Pitagora ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar, si një detyrim që rrjedh nga marrëveshja e nënshkruar ndërmjet universiteteve dhe RASH.

*Menjëherë*

**11.2 Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të adresojë në institucionet përgjegjëse që janë Ministria e Arsimit dhe RASH, çështjet që e kanë penguar të vërë në funksion sistemin Pitagora, në mënyrë që të nxiten të gjithë faktorët për qartësimin dhe saktësimin njëherë e mirë mbi të drejtën e zhvillimit të sistemeve informatike që ndërtohen në shërbim të studentëve në mënyrë që të parandalohen investime me qëllime të njëjta.

*Menjëherë*

## **B.2.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se Administratori i FSHN, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “F.V i rrjetit të internetit dhe Serverave për FSHN-në” ka dërguar preventivin dhe specifikimet teknike me shkresën nr. 1709/3 Prot. datë 09.07.2021 ku vlera e preventivit është 9,700,000 lekë, dukshëm një vlerë më e ulët se planifikimi fillestar në buxhet i këtij projekti, i cili ishte në vlerën 14,500,000 lekë. FSHN ka argumentuar se janë konstatuar pasaktësi në vlerësimin paraprak që ishte bërë për efekt të buxhetit por janë rishikuar edhe zgjidhje teknike të verifikuara në terren të cilat kanë dhënë efekte në uljen e preventivit dhe në përmirësimin e infrastrukturës së fakultetit. Në vlerën e miratuar ishte përfshirë edhe ndërtimi i një website të ri dinamik me vlerë 2,000,000 lekë por duke qenë se ishin në përfundim të afatit të aksesit të faqes ekzistuese në google, nga FSHN për këtë website është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh në fakultet. Për sa më sipër, vlera e planifikuar është konsideruar si e ezauruar duke e zbritur shumën nga planifikimi fillestar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 17-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës të nxjerrë përgjegjësitë dhe të kërkohet ndjekja e procedurave të nevojshme administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin e vlerës 2,000,000 lekë pa TVSH mbi ndërtimin e një website për FSHN ndërkohë që vetë fakulteti ka sqaruar se për këtë website është shfrytëzuar një procedurë shërbimesh dhe vlera është konsideruar si e ezauruar duke e zbritur vlerën nga planifikimi fillestar i buxhetit.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Titulli i Gjetjes:** Nga auditimi i procedurave “Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2020” dhe Mirëmbajtje e zakonshme pajisjesh elektronike për UT viti 2021” u konstatua se shërbimet e kërkuara në specifikimet teknike janë të mbivendosura me shërbimet dhe detyrat e specialistëve IT dhe si pasojë për vitet 2020 dhe 2021 janë shpenzuar 3,492,600 Lekë pa TVSH pa efektivitet nga buxheti i Universitetit të Tiranës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 17-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandim:** Titullari i autoriteti kontraktor, të marrë masa në vijimësi në organizimin e procedurave të prokurimit të argumentojë hartimin e fondit limit bazuar në dokumentacion justifikues që përcakton nevojën për punë, shërbime dhe mallra, për të shmangur përdorimin pa efektivitet të fondeve në të ardhmen.

***Menjëherë***

**2. Titulli i gjetjes:** Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve në UT, me shkresën nr. 1933/1 Prot. datë 12.07.2021 i ka drejtuar një kërkesë subjektit “K” shpk, me një procedurë blerje me vlerë 100,000 lekë, për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe projekt – preventiv me objekt “Instalim dhe rinovim i rrjetit të internetit” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, me fond limit 12,050,433.30 lekë pa TVSH. Preventivi dhe specifikimet teknike të dërguara nga FSHN nuk janë marrë parasysh dhe për pasojë blerja e procedurës me vlerë 100,000 lekë është shpenzim pa efektivitet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 17-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Titullari i autoritetit kontraktor, në vijimësi të marri masa mbi organizimin e procedurave të prokurimit ku të analizojë dhe argumentojë nevojën për përdorimin e tyre në mënyrë që në të ardhmen të shmanget përdorimi pa efektivitet i fondeve.

***Menjëherë***

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**